



Tezë Masteri

**„ Analiza e procesit të falimentimit të kompanive në Republikën e
Maqedonisë, nëpërmjet dy rasteve studimore : „ Shik Jellak „ Tetovë dhe
„Teteks Yarn,, Tetovë**

Kandidati:

Dardane Ismaili

Mentor:

Prof.Dr.Rufi Osmani

Shkurt, 2018

STRUKTURA E TEZËS

1. KAPITULLI 1

1.1 Abstrakti

1.2 Hyrje

2. KAPITULLI 2

KUPTIMI I FALIMENTIMIT

2.1 Nocioni i falimentimit

2.2 Qëllimet e procedurës së falimentimit

2.3 Kushtet e procedurës së falimentimit

2.4 Organet përkatëse të procedurës së falimentimit

2.5 Gjykatësi i falimentimit

2.6 Drejtori i falimentimit

2.7 Këshilli i kreditorëve

2.8 Kuvendi i kreditorëve

3. KAPITULLI

PLANI PËR RIORGANIZIM

3.1 Nocioni i riorganizimit

3.2 Përpilimi i planit të riorganizimit

3.3 Përmbajtja e planit të riorganizimit

3.4 Dorëzimi i planit të riorganizimit

3.5 Pranimi dhe lejimi i planit

3.6 Pagesat sipas planit

3.7 Mbyllja dhe kontrolli i planit

3.8 Të drejtat e drejtorit të falimentimit

3.9. Hapja e sërishme e procedurës së falimentimit

4.REZULTATET NGA ANALIZAT E PASQYRAVE FINANCIARE

4.1 Historitë dhe statuset e ndërmarrjeve të falimentuara

4.1.1 Historia e ‘‘Shik Jelak’’ Tetovë

4.1.2 Historia e Tetks Yarn – Tetovë

4.2 Arsyet e falimentimit dhe masat që u ndërmorën nga udhëheqësia për tejkalimin e së njëjtës

4.2.1 Arsyet e falimentimit të ‘‘SHA Shik Jelak’’

4.2.2 Arsyet e falimentimit të ‘‘Teteks Yarn’’

4.3 Analiza financiare

4.3.1 Analiza e gjendjes financiare të ‘‘Shik Jelak’’

4.3.2 Analiza e gjendjes financiare të ‘‘Tetks Yarn’’

4.4 Analiza në bazë të koeficientëve financiarë të ‘‘Teteks Yarn’’ dhe ‘‘Shik Jelak’’

4.4.1 Likuiditeti

4.4.2 Borxhi

4.4.3 Profitabiliteti

4.5 Analiza e tri modele të bankrotit: Altman Z-rezultati, Konan - Holder dhe Taffler

4.5.1 Rezultatet e përfituara nga zbatimi i modelit të Altman Z-score

4.5.2 Rezultatet e përfituara nga zbatimi i modelit për bankrot Konan Holder

4.5.3 Rezultatet e përfituara nga zbatimi i modelit për bankrot Taffler (Taffler)

4.6 Elementet kryesore të procedurës së falimentimit tek ndërmarrjet e hulumtuara

4.7 Konkluzioni

KAPITULLI 1

Abstrakti

Në kohën e sodit shpesh ndeshemi me fjalën falimentim, si një firmë mundet të falimentojë apo si mund që ti shmangemi procedurës së falimentimit. Dallohen mendime të ndryshme rreth procedurës së falimentimit dhe shmangies së falimentimit nëpërmjet Planit të riorganizimit.

Një plan i mirë i riorganizimit të debitorit të falimentuar mund të ndikojë pozitivisht në mënyrë që debitori i falimentuar të mund të vazhdojë së ekzistuarit. Riorganizimi është një mundësi shumë e mirë për kreditorët sepse nëpërmjet saj kreditorët do të arrijnë pagesa maksimale përkundër falimentimit ku ato do të shuheshin, dhe në këtë mënyrë debitori i falimentuar do të vazhdon të ekzistojë.

Në këtë punim do të studioj dy raste studimore, atë të procedurës së falimentimit dhe planit të riorganizimit si një mundësi e dytë, në bazë të Ligjit dhe standardeve për procedurën e falimentimit në Maqedoni.

Hyrja

Në shoqërinë tonë falimentimi perceptohet si një punë shumë e ndjeshme, si një katastrofë e cila mund të godasë çdo firmë/shoqatë, bashkëpunëtorët e sajë, kreditorët dhe të punësuarit në atë shoqatë. Nga një procedurë e zgjatur për falimentim pasojat mund të jenë nga më të ndryshmet, ku pas mbylljes së debitorit, ngritjes së padisë ligjore të pronës/pasurisë së tij, sjell atë që shumë familje të mbesin pa punë, firmat të vendosen në dry, ndërsa kreditorët të mos kenë mundësi që me vite ti shlyejnë kërkesat e tyre, madje edhe nëse arrihet ndonjë marrëveshje me kreditorët nga debitori i falimentuar kjo do të ishte në një përqindje shumë e vogël dhe pothuajse gati asnjëherë nuk janë paguar apo shlyer kërkesat në tërësi.

Është krijuar një traditë që prona apo pasuria e debitorit të tjetërsohet, gjegjësisht të shitet me çmim shumë të ulët, që kjo direkt të ndikon në përqindjen e pagesës dhe e gjithë kjo krijoi pasoja negative që pjesëmarrësit në procedurë, kreditorët të sillen me mosbesim ndaj procedurës së falimentimit që shpesh ndodhë në Republikën e Maqedonisë, e cila kohët e fundit është bërë si traditë e biznesmenëve.

Duke u bazuar në këtë, tek ky punim magjistrature do të paraqes një pasqyrë më të qartë se çka me të vërtetë paraqet riorganizimi i debitorit/borxhliut dhe çfarë rezultatesh do të arrihen me riorganizimin e debitorit si dhe çfarë paraqet falimentimi, cilat janë arsyet dhe pasojat e tij dhe do të sqarojmë në mënyrë te detajuar nocionin falimentim dhe masë falimentuese ,qëllimin e procedurës falimentuese, organet në procedurën falimentuese si dhe definimin e kreditorëve të falimentuar.

Qëllimi i studimit

Qëllimi kryesor i studimit në këtë tezë magjistrature paraqet përdorimi efikas i metodave bashkëkohore të analizës së pasqyrave financiare dhe te analizave te tjera te performances statike dhe dinamike te kompanive si një instrumentarium I rendesishem për menaxhimin me sukses te procesit te falimentimit te kompanive në funksion te riaktivizmit ose te bankrotit perfundimtar.

Në kohën e sodit shpesh ndeshemi me fjalen falimentim, si një firmë mundet të falimentojë apo si mund që ti shmangemi procedurës së falimentimit. Dallohen mendime të ndryshme reth procedurës së falimentimit dhe shmangies së falimentimit nëpërmjet Planit të riorganizimit.

Një plan i mirë i riorganizimit të debitorit të falimentuar mund të ndikojë pozitivisht në menyrë që debitori në procese te falimentimit të mund të vazhdojë së ekzistuarit. Riorganizimi është një mundësi shumë e mirë për kreditorët sepse nëpërmjet saj kreditorët do të arrijnë pagesa maksimale përkundër falimentimit ku ato do të shuheshin, dhe në këtë menyrë debitori i falimentuar do të vazhdon të ekzistojë.

Në këtë punim do të elaboroj performancën financiare të dy raste studimore atë të procedurës së falimentimit dhe planit të riorganizimit si një mundësi e dytë, në bazë të Ligjit dhe standardeve për procedurën e falimentimit në Maqedoni.

Analiza financiare është instrumentarium shumë I rëndësishem për të detektuar performancën reale të kompanisë në kuadrin e analizës së mundësive për riaktivizim ose për mbyllje finale të kompanisë. Në këtë punim do të përdorim disa nga mjetet e analizës financiare siç janë:

- Analizat dinamike dhe statike të PF,
- Analizat e treguesve kryesor financiar,
- Analizat e bankrotit potencial,
- Auditimi dhe analizat tjerat financiare ,

Interpretimi i gjithë mjeteve dhe indikatorëve financiarë, do të na mundësojë një pasqyrë reale të menaxhimit të ndërmarrjeve në tregun e Maqedonisë.

Hipotezat

Hipoteza kryesore: Procesi I falimentimit të kompanive mund të efektuon mbylljen (bankrotin) e kompanisë ose riaktivizimin e kompanisë në varshmeri nga performanca e kompanisë para fillimit të procesit të falimentimit ,

Hipotezat Ndihmëse: Menaxhimi I suksesshem I procesit të falimentimit nga udhëheqesi falimentues nëpërmjet një programi reformues mund të realizon ristrukturimin e borxheve dhe ndryshimin e strukturës pronësore të kompanisë.

Metodologjia e hulumtimit

Në ditët e sotme analiza e raporteve financiare është njëra nga disiplinat më e njohshme dhe më frytdhënëse në sferën e financiare . Në këtë sferë do të shfrytëzohen metoda të ndryshme të analizës së raporteve financiare do të përdoren edhe teknika të përgjithshme dhe të veçanta shkencore me ndihmën e të cilave do të arrihet deri në përfundime dhe rekomandime.

1. Metoda të përgjithshme shkencore

- Do të përdoret **metoda e analizës financiare dhe menaxheriale**, si pjesë e hulumtimit që do të bazohet në pasqyrat financiare dhe dokumentet tjera financiar dhe menaxheriale dhe dokumente tjera të rëndësishme që do të shfrytëzohet për të qenë sa më efikase në analizimin e gjendjes së këtyreve ndërmarrje
- Prej metodave të përgjithshme shkencore do të përdoret **metoda statistikore**, ku në mënyrë kuantitative do të jepen tabela dhe grafike me të dhëna për gjendjen aktuale dhe gjendjen në 5 vitet e fundit të ndërmarrjes.
- Poashtu, do të përdoret **metoda komparative (krahasuese)**, ku do të shqyrtohet gjendja dhe menaxhimi i ndërmarrjeve në fjalë .

2. Metoda të veçanta shkencore

- Metoda kualitative dhe kuantitative
- Metoda e analizës dinamike dhe strukturore
- Metoda e pikës kritike të rentabilitetit dhe metoda të tjera ,
- Analizat e relevances financiare ,
- Metodatat e vlerësimit të qendrave të kostos,profitit dhe investimeve
- Analizat tjera financiare dhe ekonomike ,

Menaxhimi I procesit te falimentimit te kompanise “ SHIK JELLAK”

1. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve dhe analiza e cilesis dhe mundesis se arketimit dhe pageses në kuader te raportit te inventarizimit ,
2. Pergatitja dhe analiza e bilancit fillestar falimentues.
3. Analiza e detajuar e perpuethshmeris se detyrimeve ndaj furnitoreve në baze te aplikimeve formale dhe perpilimi i nje asqyre skematike me pranimin dhe hudhjen e kerkesave (detyrimeve) per te cilat nuk ka mbulesa finaciare dhe materiale në bilancin fillestar falimentues .
4. Vleresim analitik konform SNK dhe procesit te falimentimit te aktiveve afatgjate , inventareve dhe kapitalit themelor te falimentuesit nga bashkepunëtor profesional te lemise te falimentimit.
5. Analize detale finaciare duke perfshire dhe analizen e bankrotit potencial sipas modelit Altman, Konan-Holder dhe Tafler ,
6. Pregaditja e raportit final per gjendjen ekonomike dhe financiare te debitorit SHIK JELAK AD - në falimentim – Tetove me propozim per falimentim.

Menaxhimi I procesit te falimentimit nëpërmjet riaktivizmit të kompanisë “ Teteks Yarn –Tetove ”

1. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve dhe analiza e cilesis dhe mundesis se arketimit dhe pageses n; kuader te raportit te inventarizimit.
2. Pergatitja dhe analiza e bilancit fillestar falimentues.
3. Analiza e detajuar e perpuethshmeris se detyrimeve ndaj furnitoreve në baze te aplikimeve formale dhe perpilimi i nje asqyre skematike me pranimin dhe hudhjen e kerkesave (detyrimeve) per te cilat nuk ka mbulese finaciare dhe materiale në bilancin fillestar falimentues .
4. Vleresim analitik konform SNK dhe procesit te falimentimit te aktiveve afatgjate , inventareve dhe kapitalit themelor te falimentuesit nga bashkepunëtor profesional te lemise te falimentimit.
5. Analize detale finaciare duke perfshire dhe analizen e bankrotit potencial sipas modelit Altman, Konan-Holder dhe Tafler ,
6. Pregaditja e raportit final per gjendjen ekonomike dhe finaciare te debitorit “ Teteks Yarni –Tetove në falimentim - Tetove.
7. Perpilimi i planit te riorganizimit te Teteks Yarni –Tetove në falimentim - Tetove.

KAPITULLI 2

KUPTIMI I FALIMENTIMIT

2.1. Nocioni i falimentimit

Në përditshmëri vazhdimisht ndeshemi me përdorimin e termit falimentim, procedurë të falimentimit, debitor i falimentuar, drejtor falimentues, kreditor i falimentuar dhe shumë terme tjera të cilët në vete e bartin fjalën falimentim ose i falimentuar.¹

Fjala falimentim ka prejardhje latine, rrjedh nga fjala concursus dhe atë prefiksi **con** - tregon diçka të përbashkët, ndërsa folja **curere** - do të thotë të vrapohet, që në përkthim do të thotë ; të vrapohet bashkërisht për ndonjë qëllim, bë bazë të standardeve, rregullave dhe kushteve paraprakisht të përcaktuara.²

Në kuptimin juridik, falimentimi si institut i së drejtës të shoqatës, definohet si mënyrë jo e dëshirueshme e ndërprerjes së subjektit juridik të një shoqate tregtare. Megjithatë, falimentimi njëkohësisht paraqet dhe instrument të tregut, përmes së cilit kryhet seleksionimi i shoqatave të suksesshme nga shoqatat të cilat nuk kanë arritur të mbijetojnë në treg, duke i shikuar falimentimin nga aspekti ekonomik.³

Zakonisht, falimentimi gati se gjithmonë pasqyrohet me mundësinë që debitori nëpërmes procedurës për falimentim të fshihet nga Regjistri Qendror- tregtar, të shpëtojë nga përbushja e obligimeve të papërbushura krijon sinonim të diçkaje negative, ndërsa ajo pasqyrë është e krijuar nga pasojat negative, të cilat i ka falimentimi ndaj të punësuarve, partnerëve të tyre në firmat ndaj të cilave është e hapur procedurë për falimentim.

Gjithmonë kur bëhet fjalë për falimentimin si nocion, patjetër duhet të kemi parasysh se ligji për falimentim është një pjesë e rëndësishme e çdo sistemi juridik, përfshirë këtu edhe sistemin tonë juridik dhe zbatimin e tij, është e nevojshme për tregun ekonomik dhe atë për këto shkaqe: siguron procedurë për likuidim të dhunshëm të shoqatave jolikuiduese, pagesë maksimale të kërkesave të kreditorit dhe njëkohësisht i nxitë kreditorët të investojnë mjete me sigurim të drejtave të tyre për pagesë.

Si anë tjetër pozitive e ligjit për falimentim është mekanizmi për shpëtim të debitorëve/borxhlinjve, përveç likuidimit të debitorëve të jolikuiduar, mund të sjellë deri tek sanimi i tyre dhe rehabilitimi financiar dhe vazhdimi me punë vetëm në bazë ekonomike.⁴

¹ Kostovski, D. (2007) Ligji për falimentim-Komentar. Shkup: Projekti për veprimet/efektet qarkulluese fq. 19,

² Sipas references paraprake fq.19

³ Kostovski, D.Dhe Haxhi Vasileva, B. "Riorganizimi i shoqatave tregtare në procedurën e falimentimit,fq. 21

⁴ Kostovski, D. (2007) Ligji për falimentim-Komentar. Shkup: Projekti për veprimet/efektet qarkulluese,fq. 19

Ligji për falimentim duhet të sigurojë zbatimin e shpejtë dhe efikas të kësaj procedure nga gjykatat, barazi të të gjithë kreditorëve dhe falimentimi të shikohet si mjet praktik dhe i sigurt për pagesë maksimale të kërkesave së kreditorëve. Por, që të realizohen këto funksione dhe falimentimi të shikohet me pozitivizëm, për të e nevojshme është gjykatë kualitative, gjegjësisht organizim adekuat i gjykatave, të cilët do ta udhëheqin këtë procedurë të falimentimit, gjykatës profesionale, gjegjësisht kuadro me kualifikime të larta dhe organizim adekuat i organeve tjera të procedurës së falimentimit, e veçanërisht drejtorë të falimentimit me etikë dhe kualifikim të lartë.⁵

2.2. Qëllimet e procedurës së falimentimit

Si qëllim kryesor i procedurës së falimentimit është të paguarit apo shlyerja e borxheve apo kërkesave të kreditorëve në përgjithësi. Një karakteristik tjetër që këtë procedurë e bën të jetë më ndryshe nga të gjitha procedurat tjera përmbarese është karakteri i saj kolektiv në pagesën e kërkesave, ku kreditori paguhet individualisht nga debitorët e tij.

Gjithashtu procedura e falimentimit paraqet edhe shans të fundit të kreditorëve që t'i shpagojnë/shlyejnë kërkesat e tyre nga debitori.⁶

Mënyra e parë e shlyerjes kolektive të kërkesave të kreditorit është me zbatim të procedurës për ngritje të padisë ndaj pronës së debitorit/borxhliut dhe shpërndarjen e mjeteve të realizuara të kreditorit.

Mënyra e dytë e shlyerjes kolektive të kërkesave të kreditorit është përmes lidhjes së kontratës të veçantë për barazim/rënie në ujdi me kreditorët. Marrëveshja për barazim duhet të jetë e përfshirë me planin e propozuar për riorganizim. Qëllimi i planit për riorganizim është që shoqata të vazhdojë me punën e mëtutjeshme për shlyerjen e të gjitha obligimeve ndaj kreditorëve.

Në Ligjin për falimentim, më saktësisht në nenin 3 është i definuar qëllimi i procedurës së falimentimit, prandaj në nen qëndron:

Procedura e falimentimit ka për qëllim shlyerjen kolektiv të kreditorëve të debitorit të falimentuar (në tekstin në vazhdim: debitorit/borxhliut), me transferimin e pronës së debitorit dhe shpërndarja e mjeteve (të ardhurave) të realizuara të kreditorëve ose me lidhje të marrëveshjes së posaçme për rregullim të kërkesave të përcaktuara me planin për riorganizim, që është i drejtuar nga ruajtja e mëtutjeshme e punës së ndërmarrjes së debitorit.

⁵ BID. Fq. 20 ,

⁶ Brajanovski, B., Beliçanec, T. Dhe Nikollovski, A. Komentari për Ligjin për falimentim fq. 17

*Me riorganizimin mund të kryhet edhe zgjidhja e kërkesave para hapjes së procedurës për falimentim me kushte të përcaktuara me këtë ligj.*⁷

Ligji për falimentim jep edhe mundësi tjetër që të zgjidhet gjendja e jo likuiditetit, organizim ose zgjidhjes vullnetare të jolikuditetit jashtë procedurës së falimentimit. Edhe një qëllim në procedurën për falimentim është që nëpërmes kësaj procedure të eliminohen shoqatat të cilat nuk arritën të qëndrojnë dhe ekzistojnë në tregun ekonomik, të gjitha shoqëritë të cilat nuk arrin në kohë të caktuar ti shlyejnë detyrimet ndaj debitorëve.

Ky qëllim është i rëndësishëm edhe në të ashtuquajturën domino efekt, i cili për shkak të pamundësisë që ndonjë kreditor ta arkëtojë borxhin, shkakton që edhe kreditorit të i'a cënojë likuiditetin.⁸

Ligji për falimentim është preciz në lidhje me personat ndaj të cilëve mund të hapet procedurë për falimentim dhe ndaj të cilit nuk mund të udhëhiqet procedurë e falimentimit, prandaj edhe në ligj taksativisht është e theksuar ndaj cilës pronë nuk mund të udhëhiqet procedurë e falimentimit, e ajo është prona e Republikës së Maqedonisë, ndaj fondeve të cilat financohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, fondeve për sigurim pensional dhe invalidor, Fondit për sigurim shëndetësor, njësisive të vetëqeverisjes lokale, ndaj organeve të administratës shtetërore, si dhe të personave tjerë juridik me autorizim publik, por me kusht që me ligj të jenë të përjashtuar nga procedura për falimentim.⁹

2.3. Kushtet për realizimin e procedurës së falimentimit

Një kusht kryesorë dhe i përgjithshëm për realizimin e procedurës së falimentimit të një firme është paaftësia e pagesës së detyrime ndaj bashkëpunëtorëve të saj.

Insolvencioni definohet si gjendje kur debitori/borxhliu nuk është i aftë t'i shlyejë kërkesat e arritura të kreditorëve.¹⁰ Përkatësisht, nëse në periudhë prej 45 ditësh, nga e cila do qoftë llogari, në të cilën ka qenë bartës i qarkullimit pagesor, nuk është i shlyer detyrimi ose nuk është paguar shuma e cila duhej të paguhet sipas bazës së pagesës/transaksionit që është në fuqi, pagesa bëhet insolvente/e paaftë.¹¹

Në rregullativën ligjore, madje kushtet për hapjen/ngritjen e procedurës për falimentim janë të rregulluara në nenin 5 të Ligjit për falimentim, dhe atë në alinenë 1 të këtij ligji qëndron se “*falimentim*

⁷ Shiko: neni 3 nga Ligji për falimentim, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/06

⁸ Kostovski, D. (2007) Ligji për falimentim-Komentar. Shkup: Projekti për veprimet/efektet qarkulluese, fq. 60

⁹ Brajanovski, B., Beliçanec, T. Dhe Nikollovski, A. Komentar për Ligjin për falimentim fq. 19

¹⁰ Kostovski, D. Ligji për falimentim-komentare, sqarime, praktikë gjyqësore dhe regjistër lëndësh. Akademik 2014, fq. 6

¹¹ Kostovski, D. dhe Haxhi Vasileva, B. “Riorganizimi i shoqatave tregtare në procedurën e falimentimit”, fq. 9

ose riorganizim i debitorit të falimentuar realizohet kur debitori i falimentuar është i paaftë për pagesë dhe e pret paaftësia e ardhshme e shlyerjes së detyrimeve”.

Pastaj, në alinenë 2 është e theksuar se debitori/borxhliu është i paaftë për pagesë, nëse në periudhë prej 45 ditësh në bazë të transaksionit i cili është në fuqi, nuk është e paguar shuma që duhet të paguhet nga cilido person që është bartës i qarkullimit pagesor, por, këto dispozita nuk mund të zbatohen në këto raste, dhe atë, nëse vjen gjer te marrja e borxhit ose nëse debitori gjatë procedurës paraprahe/ të më përparshme nuk i shlyen të gjitha kërkesat të cilat i ka pasur në bazë të transaksionit i cili është në fuqi.

Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë jep vërtetim me të cilin dëshmohet se debitori është i paaftë për pagesë.

Me dispozitat nga alineja 5, rregullohet paaftësia e ardhshme për pagesë, e ajo ekziston nëse “debitori vërtetohet se detyrimet e tij ekzistuese nuk do të mund t’i përmbushë pas arritjes të tyre.¹²

Që të mundemi më lehtë të kuptojmë paaftësinë e pagesë/insolvencioni, duhet të bëhet dallimi i këtyre nocioneve:

1. Detyrime të pashlyera, të cilat akoma nuk kanë arritur për pagesë,
2. Detyrime të pashlyera, të cilat kanë arritur për pagesë, e të cilat do të shlyhen me vonesë,
3. Detyrime të papaguara, të cilat kanë arritur për pagesë, por asnjëherë nuk do mund të paguhet.

Nga dy nocionet e para e nënkuptojmë vetëm jolikuditetin e debitorit, ndërsa në nocionin e tretë bëhet fjalë për insolvencion /paaftësi për pagesë.

Shoqatat të cilat mund të konsiderohen likuide kur ata aktivitetin e tyre e realizojnë me sukses, që do të thotë, se të gjitha detyrimet është e aftë t’i paguajë në kohë të caktuar, gjegjësisht në afat të caktuar dhe në tërësi, dhe i plotëson të gjitha mundësitë që ajo gjendje e suksesshme në realizimin e detyrimeve të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Kurse në anën tjetër shenjat e para të cilat tregojnë se një shoqatë fillon të bëhet jolikude janë kur shoqata së pari fillon me vonesën e pagesës së detyrimeve ndaj shoqatave me të cilat ajo bashkëpunon, pastaj vonohet me pagesën e detyrimeve ndaj bankave, vonohet me shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit dhe faza e fundit, kur fillon me mosplotësimin e detyrimeve ndaj të punësuarve.

Kur këta tregues do të paraqiten në një shoqatë, arrihet një pasqyrë e cila tregon se shoqata fillon të bëhet jolikude. Por, kjo pasqyrë është vetëm tregues paralajmërues, e cila nëse kuptohet seriozisht mund edhe të tejkalohet, por nëse kjo nuk ndodh dhe nuk fillohet me marrjen e hapave serioze për tejkalimin e

¹² www. Akademika.com.mk Ligji për falimentim (tekst i konsoliduar), neni 5,

kësaj faze, është shumë e qartë dhe e sigurt se insolvenconi/paaftësia për pagesë shumë shpejtë do bëhet realitet.¹³

2.4. Organet përkatëse të procedurës së falimentimit

Organet të cilat janë kompetente në procedurën e falimentimit janë : gjykatësi për falimentim dhe drejtori për falimentim, të cilët llogariten si organe gjyqësore dhe këshillat e kreditorëve dhe kuvendi i kreditorëve në anën tjetër, të cilat konsiderohen si organe jashtëgjyqësore.

2.5. Gjykatësi i falimentimit

Gjykatësi i falimentimit ka më shumë autorizime, duke filluar nga sjellja e vendimit për ngritje të procedurës paraprake në të cilën konfirmohet a ekzistojnë kushte për hapje/ngritje të procedurës për falimentim. Dhe nëse konfirmohet se kushtet janë të përmbushura për hapje të procedurës për falimentim, atëherë gjykatësi ka të drejtën të realizojë duke u bazuar në propozimin për ngritje të procedurës së falimentimit.

Gjykatësi i falimentimit ka edhe autorizime tjera: e emërton dhe shkarkon drejtorin e përkohshëm të falimentimit dhe drejtorin e falimentimit, vendos kontestet e drejtorit të falimentimit, vendos për kontestet e kreditorit, këshillit të kreditorëve dhe kuvendit të kreditorëve. Një autorizim tjetër i rëndësishëm që e ka gjykatësi i falimentimit është se ai kryen kontroll mbi ligjshmërinë e punës të drejtorit të falimentimit, ku i lejon llogaritë e harxhimeve në procedurën e falimentimit, cakton dhurata dhe shpagim të harxhimeve të drejtorit të falimentimit dhe anëtarëve të këshillit të kreditorëve, përcakton avanset për mbulesën e harxhimeve, lejon transaksione të kredive, sjell vendim për mbyllje të procedurës së falimentimit.

Gjykatësi i falimentimit mund t'i ndërrojë edhe vendimet e drejtorit të falimentimit nëse e vërteton se janë në kundërshtim me ligjin, i jep udhëzime me shkrin drejtorit të falimentimit për realizimin e detyrimeve të tij të përcaktuara me ligj, të cilat për drejtorin e falimentimit janë të obligueshme dhe e përcjell punën e këshillit të kreditorëve dhe të kuvendit të kreditorëve.¹⁴

¹³ Kostovski, D. Dhe Haxhi Vasileva, B. "Riorganizimi i shoqatave tregtare në procedurën e falimentimit", fq. 9

¹⁴ Brajanovski, B., Beliçanec, T. Dhe Nikollovski, A. Komentar për Ligjin për falimentim fq. 46

2.6. Drejtori i falimentimit

Drejtori i falimentimit e ka një rëndësi prej detyrave më kryesore në procedurën e falimentimit, e kjo është që të arrihet pagesë/shlyerje maksimale e shumës së kërkesave të kreditorit. Prandaj, drejtori e falimentimit si person i autorizuar që ta udhëheq riorganizimin ose likuidimin e debitorit, e ka detyrë shumë të rëndësishme të ndërlikuar.¹⁵

Pra, drejtori i falimentimit duhet të jetë person i cili do të veçohet me dituri dhe përvojë, gjegjësisht profesionalizëm, që do të veprojë sipas ligjit, do të jetë objektiv, person me moral dhe etikë të lartë, dhe këto veçori asnjëherë nuk duhet të vihen në dyshim, dhe ato janë garant që asnjëherë nuk do të punojë në dëm të pronës/pasurisë së debitorit të falimentuar, por as edhe në dëm të kreditorit.¹⁶

Gjithashtu përgjegjësi dhe obligim shumë i madh i drejtorit për falimentim është ajo që menjëherë pas hapjes/ngritjes së procedurës për falimentim e merr në qeverisje dhe administrim të gjithë pronën e debitorit të falimentuar.

Drejtori për falimentim është i emërtuar nga ana e Gjyqit dhe ai duhet ti plotëson këto kushte : të jetë i pajisur me licencë për kryerje të punës drejtor falimentimi, të jetë i regjistruar në regjistrin tregtar si tregtar individual, shoqatë tregtare publike, gjegjësisht shoqatë me përgjegjësi të kufizuar, e specializuar vetëm për kryerje të punëve të lidhura me udhëheqjen e procedurës së falimentimit dhe për punim të planit për riorganizim, i cili është pajisur me licencë për drejtor falimentimi dhe të jetë anëtar i Odës për drejtor falimentimi.¹⁷

2.7. Këshilli i kreditorëve

Roli i këshillit të kreditorëve para së gjithash është mbrojtja e interesave të kreditorëve dhe mbikëqyrje mbi punën e organeve tjera në procedurën e falimentimit. Anëtar i këshillit të kreditorëve mund të jetë secili kreditor i cili në pajtim me Ligjin për falimentim e ka paraqitur kërkesën e tij, ndërsa drejtori i falimentimit e llogarit si themelues.

Në këshill nuk mund të anëtarësohet kreditor i cili njëkohësisht është edhe debitor/borxhli i debitorit/borxhliut të falimentuar, kreditor i cili në dy vitet e fundit ka qenë i emëruar për anëtar të organeve drejtuese ose organeve për mbikëqyrje ose prokurori i debitorit të falimentuar, kreditor i cili është i emëruar për anëtar të organit për administrim ose organit për mbikëqyrje, nëse ka pozitë të personit të afërt me kreditorët e lartpërmendur, kreditor jo i siguruar, drejtor për falimentim, përmbarues, noter, vlerësues/përlllogaritës ose kontabilist, në cilësi të kreditorit.¹⁸

¹⁵ Kostovski, D. Ligji për falimentim-komentare, sqarime, praktikë gjyqësore dhe regjistër lëndësh. Akademik 2014, fq. 108,

¹⁶ Brajanovski, B., Beliçanec, T. Dhe Nikollovski, A. Komentari për Ligjin për falimentim fq. 74 ,

¹⁷ Neni 20 nga ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për falimentim, Gazeta zyrtare e RM. nr. 79/13

¹⁸ Kostovski, D. Ligji për falimentim-komentare, sqarime, praktikë gjyqësore dhe regjistër lëndësh. Akademik 2014, fq. 204,

2.8. Kuvendi i kreditorëve

Në kuvendin e parë të kreditorëve ose në kuvendin raportues, kreditorët janë të autorizuar të vendosin për zgjedhje të anëtarëve të këshillit të kreditorëve, verifikimin e drejtorit (të përkohshëm) të falimentimit, gjegjësisht zgjedhjen e tij, të vendosin për vazhdimin me punën ndërmarrëse/efektin e punës së debitorit dhe për mënyrën për paditje të pronës dhe të vendos se a do të fillojë me përgatitjen e planit për riorganizim.

Në kuvendet tjera të kreditorëve, kreditorët kanë të drejtë:

1. Të kërkojnë të dorëzojnë raporte për masën falimentuese,
2. Të kërkojnë raporte për gjendjen e masës falimentuese,
3. Qarkullimi dhe parat e gatshme me të cilat posedon drejtori për falimentim.

KAPITULLI 3

KUPTIMI I PLANIT PËR RIORGANIZIM

3.1. Nocioni i riorganizimit

Ligji i falimentimit i definton të dy nocionet, nocionin e riorganizimit dhe atë të procedurës së riorganizimit. Riorganizimi është i defnuar si proces me të cilën gjendja financiare e debitorit mund të ripërtërihet, ndërsa debitori të vazhdojë me punë, dhe kjo të arrihet me mjete siç është shlyerja e borxheve, shtyrja e borxhit, transformimi i borxhit në pjesë në shoqatë dhe shitja e ndërmarrjes si tërësi ose pjesë të saj. Ligji për falimentim e definton edhe procedurën për riorganizim si procedurë e cila përfshin propozimin e debitorit për ngritje të procedurës për riorganizim, deklarim të debitorit pas propozimit, përgatitjen e planit për riorganizim, deklarimin e kreditorëve pas planit për riorganizim dhe të gjitha aktiviteteve të cilat i ndërmerr gjykatësi i falimentimit, debitori dhe kreditori në lidhje me riorganizimin.¹⁹

Riorganizimi ka për qëllim barazimin e kërkesave të kreditorëve dhe atë në një sasi më të madhe. Gjithashtu definohet edhe si arritje të marrëveshjes së posaçme për barazimin e kërkesave, me qëllim që debitori të vazhdojë të punojë me sukses.

Ndërsa procedura për riorganizim të debitorit i përfshinë të gjitha aktivitetet të cilat i ndërmarrin gjykatësi i falimentimit, debitori dhe kreditori në lidhje me riorganizimin e debitorit, duke u udhëhequr nga plani për riorganizim.

3.2. Përpilimi i planit të riorganizimit

Dallohen disa mënyra të realizimit të riorganizimit, varësisht nga ajo se me riorganizimin i kthehet subjektiviteti juridik debitorit ose jo, ku bëhet dallimi në mes riorganizimit që të vazhdohet subjektiviteti juridik i ndërmarrjes së debitorit dhe riorganizim me ndarje të pjesës së të ardhurave të ndërmarrjes nga struktura pronësore e debitorit.

Mënyra e parë e riorganizimit realizohet në atë mënyrë ku debitorit i lejohet që të vazhdojë të udhëheqë dhe disponojë te gjithë pronën e tij apo vetëm një pjesë të saj dhe me të ti kthejë kërkesat e kreditorëve, pra organeve udhëheqëse u jepet shans i dytë që ta ndryshojnë gjendjen financiare të debitorit. Me anë të planit të riorganizimit mund të arrihet deri tek ndryshimi i tërësishëm i strukturës

¹⁹ Brajanovski, B., Beliçanec, T. Dhe Nikollovski, A. Komentar për Ligjin për falimentim, fq. 14

pronësore të debitorit duke ardhur kreditorët ose personat e tretë në vendin e tyre, e gjithë kjo realizohet që të paguhet apo barazohen një pjesë ose të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve.

Mënyra e dytë e planit të riorganizimit arrihet me ndryshime statusore të debitorit, gjegjësisht bashkimin e tij me një ose më shumë persona dhe eliminim e debitorit nga qarkullimi pagesor. Me anë të këtij lloji të riorganizimit bartet e gjithë prona e debitorit ose një pjesë e saj në një ose më shumë persona juridik të cilët ekzistojnë apo do të themelohen. Detyrimet ndaj kreditorëve të debitorit do të merr shoqata e re e cila formohet në bashkangjritjen me debitorin. Këto masa duhet të ndërmerren si plotësim i masave tjera për riorganizim; me funksionim të pavarur të këtyre masave fitohet përshtypje se nuk kryhet riorganizim, por shkohet kah paditja e pronësisë së debitorit.²⁰

3.3. Përmbajtja e planit të riorganizimit

Përmbajtja e planit të riorganizimit rregullohet nga ana a ligjvënësit, në bazë të nenit 215-b, sipas të cilit plani duhet të përmbajë : pjesën përgatitore, pjesën përmbajtëse në të cilën në mënyrë të detajuar do të theksohet se cilat masa dhe me cilat mjete do të zbatohet realizimi i planit.

Elementet të cilat e përbëjnë planin e riorganizimit janë: lista e kreditorëve me ndarje në klasa dhe përmenden kriteret për formimin e klasave, lartësia e shumës në para ose pronës e cila shërben për pagesën/shlyerjen e kreditorëve, procedura e pagesës/shlyerjes së kreditorëve dhe dinamika e pagesës, përshkrimi i procedurës për shitje të pronës si dhe vendosen afatet për zbatimin e planit të riorganizimit.

Plani i riorganizimit përcakton listën e anëtarëve të organeve për udhëheqje, mjetet shitesë/mëditjet të tyre, listën e ekspertëve të cilët kanë qenë të angazhuar dhe shumat e mëditjeve të tyre, emri i personit profesional i cili ka kryer mbikëqyrje, mënyrën në të cilën do të i lajmërojë kreditorët për zbatim të planit si dhe shumën dhe dinamikën e pagesës së shpërbllimit për angazhimin e tij.

Në këtë plan përpilohen raportet vjetore financiare, projektet financiare, data e fillimit të planit të riorganizimit, afati për zbatimin e planit, ndryshime të afateve për arritje të qëllimeve në raste kur nuk arrihen afatet e caktuara, shkallat e kredive dhe kamatave ose kushtet tjera të huamarrjes.

Plani për riorganizim përveç këtyre elementeve, përmban edhe dispozita me të cilat përcaktohet se kërkesat e kreditorëve të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat e planit për pagesë/shlyerje të borxheve të kreditorëve, do të paguhet/shlyhen në mënyrë të njëjtë dhe me kushte të njëjta si kërkesat e kreditorëve nga klasa e tyre, deklarata të noterizuar tek noteri nga shumica e kreditorëve sipas vlerës së kërkesave të secilës klasë të parashikuara me plan, se janë pajtuar me përmbajtjen e planit, deklaratën e debitorit të

²⁰ Kostovski, D. Ligji për falimentim-komentare, sqarime, praktikë gjyqësore dhe regjistër lëndësh.

Akademik 2014, fq. 650,

falimentuar për besueshmërinë e të dhënave dhe informacioneve të shënuara në planin, të dhënat për procedurën për përgatitje të planit për riorganizim, të dhënave për lajmërimet të dërguara, ofrim të informatave të kreditorëve dhe për rrjedhën e marrëveshjeve, raport të jashtëzakonshëm të revizorëve për gjendjen e librave tregtarë, deklaratë e revizorit se plani i përgatitur për riorganizim është i realizueshëm dhe raport të shkurtër për ngjarjet/ndodhitë gjatë punës.²¹

Nga kjo mënyrë e trajtimit të përmbajtjes së planit për riorganizim, mund të konstatojmë se ai është i hartuar/përpiluar prej tri pjesëve, pjesa e parë është pjesa përgatitore, e cila i përmban të njëjtat të dhëna si dhe plani për riorganizim i dorëzuar në procedurë për falimentim. Pjesa e dytë është pjesa përmbajtësore me të gjitha të dhënat e nevojshme të cilat janë të lidhura me masat dhe mjetet për realizim të planit dhe të gjitha të dhënat tjera të më lartpërmendura. Pjesa e tretë, është grupi i të dhënave të cilat i përkasin asaj se plani i propozuar për riorganizim prej debitorit/borxhliut a është i zbatueshëm/realizueshëm. Këto elemente janë obliguese për planin për riorganizim.²²

3.4. Dorëzimi i planit të riorganizimit

Nëse debitori/borxhliu i falimentuar me propozimin për ngritje të procedurës së falimentimit dorëzon edhe plan për riorganizim, në propozim patjetër duhet të jetë e përmendur se propozon edhe zbatim të procedurës për riorganizim, dhe me këtë qartë e shpreh vullnetin e tij se dëshiron ta zbatojë/realizojë riorganizimin.²³

Në shtojcë të propozimit duhet të bashkëngjiten dëshmi se janë të plotësuara kushtet për ngritje të procedurës së falimentimit. Gjykatësi i falimentimit vërteton se a është plani në pajtim me ligjin dhe se me planin janë përfshirë të gjithë kreditorët të cilët me votimin e tyre mund të ndikojnë në vendimin për sjelljen e planit dhe ai emërton drejtorin e përkohshëm të falimentimit.

Gjykatësi i falimentimit ka obligim që në afat prej tri ditësh nga dita e propozimit të vendosë për ngritjen e procedurës paraprake, për hulumtim të kushteve për hapje të procedurës së falimentimit dhe procedurës së riorganizimit pas planit të përgatitur për riorganizim. Mbahet seancë ku thirren të gjithë kreditorët e njohur të debitorit, në të cilën vendoset për propozimin në të cilën votohet për planin. Afati në të cilën do të mbahet seanca njëkohësisht paraqet edhe afat në të cilën duhet të mbarojë procedura e më përparshme, është 60 ditë.

Përmbajtja e planit për riorganizim është qartë dhe precize dhe rreptësisht e normuar, dhe nga kjo, patjetër t'i bashkëngjitet secili ai që është i autorizuar të sjellë, gjegjësisht të propozojë plan për

²¹ Neni 215-b nga Ndryshimet dhe plotësimi i Ligjit për falimentim nr.79/2013, 31.05.2013 vit.

²² Kostovski, D. Ligji për falimentim-komentare, sqarime, praktikë gjyqësore dhe regjistër lëndësh. Akademik 2014, fq. 656,

²³Kostovski, D. Ligji për falimentim-komentare, sqarime, praktikë gjyqësore dhe regjistër lëndësh. Akademik 2014, fq. 660

riorganizim.²⁴ Nga pjesa përgatitore e planit patjetër kreditorët të mund të informohen për gjendjen e debitorit, prandaj kjo pjesë e planit patjetër t'i përmbajë informacionet përmbajtjesore nga të cilat kreditori mund të njihet me gjendjen e debitorit, si dhe informacionet për masat të cilat do të ndërmerren me këtë plan.²⁵

Në pjesën përmbajtjesore të planit për riorganizim patjetër duhet të përfshihen masat që do të ndërmerren pas hapjes të procedurës së falimentimit. Në këtë pjesë të planit posaçërisht duhet të kihet kujdes për masat organizative, menaxhuese, ligjore, financiare, teknike dhe masave tjera në mënyrën e zbatimit të planit për riorganizim. Në këtë pjesë të planit gjithashtu do të vlerësohet se në cilën madhësi është e mundur të shlyhen kërkesat e kreditorëve.²⁶

Në rastin kur plani për riorganizim parasheh se kreditorët do të jenë të paguar nga të ardhurat, të cilat do të jenë rezultat i udhëheqjes së suksesshme të ndërmarrjes punuese të debitorit, atëherë në aneks të planit të riorganizimit do jetë regjistrimi i pronës/pasurisë së debitorit. Në planin do të përcaktohet edhe cilat të ardhura dhe cilat harxhime priten dhe planifikohen në periudhën e parashikuar për barazim/shlyerje të detyrimeve ndaj kreditorit.²⁷

3.5. Pranimi dhe lejimi i planit

Pasi që do të dorëzohet plani për riorganizim në gjyq dhe do të kalojë afati për mbikëqyrje të planit (e cila zgjat 8 ditë), gjykatësi i falimentimit në afat prej tri ditësh nga dita e fundit për mbikëqyrje e thërret kuvendin e kreditorëve për diskutim dhe votim sipas planit të propozuar për riorganizim.²⁸

Mbledhja e kuvendit të kreditorëve për deklarim dhe votim pas planit të propozuar ka tri pjesë dhe atë: pjesa e parë përmban caktimin e të drejtës votuese të kreditorëve, pjesa e dytë është shqyrtimi i planit për riorganizim nga ana e kreditorëve, dhe pjesa e tretë, e përfshinë deklarimin e kreditorëve pas planit të propozuar për votim.²⁹

Të gjithë kreditorët të cilëve iu është e pranuar kërkesa nga ana e drejtorit të falimentimit, në lartësi të kërkesës së caktuar, kanë të drejtë votimi në kuvend të kreditorëve për deklarim dhe votim sipas planit për riorganizim. Në nenin 232 nga Ligji për falimentim rregullohet shumica e nevojshme për sjellje të planit për riorganizim. Dhe, në nen qëndron se: “Ilogaritet se plani për riorganizim është i pranuar, nëse

²⁴Kostovski, D. Dhe Haxhi Vasileva, B. “Rorganizimi i shoqatave tregtare në procedurën e falimentimit”, Shkup, fq. 88,

²⁵Brajanovski, B., Beliçanec, T. dhe Nikollovski, A. Komentari për Ligjin për falimentim, fq. 319

²⁶Sipas referencës paraprake, fq. 321

²⁷IBID, fq. 322

²⁸Brajanovski, B., Beliçanec, T. dhe Nikollovski, A. Komentari për Ligjin për falimentim, fq. 331

²⁹Kostovski, D. Ligji për falimentim-komentare, sqarime, praktikë gjyqësore dhe regjistër lëndësh. Akademik 2014, fq. 682

pranohet me shumicë të thjeshtë nga shuma e përgjithshme e kërkesave nga kreditorët e pranishëm në kuvend, përveç nëse në plan nuk është e caktuar shumicë më e madhe ose deklarim në grupe.³⁰

Vendimi i plotfuqishëm i gjykatësit për falimentim me të cilin lejohet plani për riorganizim fiton cilësi të dokumentit zbatues/ekzekutiv, pas saj riorganizimi mund të fillojë, gjegjësisht riorganizimi vazhdon jashtë procedurës së falimentimit. Të obligueshme për të gjithë kreditorët dhe pjesëmarrësit në procedurë bëhen të gjitha dispozitat nga pjesa përmbajtësore e planit, pa dallim si kanë votuar kreditorët për planin e propozuar, efekti juridik i planit të lejuar për riorganizim u përket të gjithë kreditorëve. Gjithashtu të gjitha deklaratat të cilat janë pjesë përbërëse e planit për riorganizim bëhen ekzekutive.³¹

Të drejtën që t'i paguajnë/shlyejnë kërkesat/borxhet dhe ta fitojnë statusin e palës në procedurën e falimentimit e kanë vetëm kreditorët, të cilët i kanë paraqitur kërkesat e tyre në afatin e caktuar me ligj për parashtrim të kërkesave. Pastaj, gjithashtu kusht shumë i rëndësishëm që plani të prodhojë efekt juridik është që drejtori i falimentimit që t'i njohë ose t'i kontestojë këto kërkesa.

Obligimi që t'i paguajë kërkesat e kreditorëve bie mbi personin e ri, respektivisht debitorin ose personin e tretë, i cili i ka marrë obligimet nga plani për riorganizim. Të njëjtën të drejtë e kanë edhe kreditorët kërkesat e të cilëve janë kontestuar, pastaj në procedurë pas padisë janë vërtetuar dhe janë njohur nga gjyqi kompetent. Planin i lejuar për riorganizim prodhon edhe efekte juridike në lidhje me të drejtat që kreditori në procedurën e falimentimit i ka kundrejt bashkëdebitorëve të solidarizuar të debitorit dhe garancinë për të drejtat e kreditorëve, të cilat ata i kanë ndaj mjeteve/sendeve ose të drejtat që nuk paraqesin pjesë të masës së falimentuar.³²

³⁰ Neni 232 nga Ligji për falimentim, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/13

³¹ Kostovski, D., Haxhi Vasileva, B. (2007) "Riorganizimi i shoqatave tregtare në procedurën e falimentimit", Shkup, fq.122

³² Kostovski, D., Haxhi Vasileva, B. (2007) "Riorganizimi i shoqatave tregtare në procedurën e falimentimit", Shkup, fq.123

3.6. Pagesat sipas planit

Sipas planit për riorganizim, pagesat apo shlyerja e kërkesave/borxheve të kreditorit të falimentimit, të regjistruara nga drejtori i falimentimit në bazë të kërkesave të parashtruara më parë nga kreditorët dhe të cilat nuk janë të kontestuara nga debitori, mund të realizohen njëjtë sikur t'i përkasë zbatimit sipas dokumentit zbatues në pajtim me Ligjin për zbatim.³³

Kurse sa i përket kërkesave të kontestuara të cilat më vonë vërtetohen me vendimin e gjyqit i cili do të jetë i plotfuqishëm, këto kërkesa do të kenë të njëjtën forcë juridike sikurse edhe kërkesat që nuk kanë qenë të kontestuara.

Ekzistojnë raste kur subjektet në proces të riorganizimit në masë të madhe nuk i përmbushin detyrimet që janë kontaktuar sipas planit. Një obligim mund të konsiderohet se nuk është i realizuar në tërësi kur subjekti nuk ka kryer pagesë të kërkesës së arritur edhe pse ai ka qenë i thirrur nga ana e kreditorit në afat prej 15 ditësh që ta përmbushë obligimin. Në një situatë të këtillë llogaritet se subjekti në riorganizim nuk i ka përmbushur detyrimet e saja dhe në këtë rast për kreditorin, zvogëlimi i kërkesës dhe afati i caktuar për pagesë janë pa ndikim.

Në situatë të këtillë llogaritet se subjekti në riorganizim në masë të rëndësishme nuk i ka përmbushur detyrimet e marra dhe në këtë rast për kreditorin, zvogëlimi i kërkesës dhe afati i caktuar për pagesë janë pa ndikim. Me hapjen/ngritjen e procedurës së re të falimentimit dhe krijimit të pasojave juridike nga procedura e re e falimentimit, plani i lejuar për riorganizim nuk prodhon efekt juridik mbi pronën/pasurinë e debitorit, gjegjësisht subjektit në riorganizim, për të cilën tani më udhëhiqet procedura për falimentim.

3.7. Mbyllja dhe kontrolli i planit

Me vendim të posaçëm të gjykatësit të falimentimit do të mbyllet/përfundojë procedura e falimentimit. Por, procedura do të jetë e mbyllur kur më së pari do të paguhet/shlyhen kërkesat/borxhet e kreditorëve nga masa e falimentuar. Vendimi me të cilën mbyllet procedura e falimentimit bashkë më shkaqet për mbyllje të saj do publikohen, ndërsa debitori, drejtori i falimentimit dhe anëtarët e këshillit të kreditorëve do lajmërohen për atë se nga cila ditë mbyllja e procedurës së falimentimit do të fillojë të prodhojë efekte juridike. Vendimi nga ana e gjykatësit të falimentimit do të dorëzohet deri te regjistrat adekuat që të bëhet regjistrimi për mbyllje të procedurës së falimentimit.³⁴

³³ Brajanovski, B., Beliçanec, T. dhe Nikollovski, A. Komentar për Ligjin për falimentim, fq. 345

³⁴ Neni 243 nga Ligji për falimentim, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/13

Nëse kreditorët vendosin që drejtori i falimentimit ta kryejë mbikëqyrjen dhe kontrollin e realizimit të planit, atëherë autorizimet e tij vazhdojnë edhe pas mbylljes së procedurës së falimentimit. Gjithashtu edhe obligimet e këshillit të kreditorëve zvogëlohen, pra autorizimet e këshillit të kreditorëve kalojnë në kontroll të organit që është i paraparë të kryejë mbikëqyrjen dhe kontrollin e realizimit të planit për riorganizim.

Ka pasur kritika të Ligjit për falimentim në lidhje me vendosjen e mbikëqyrjes dhe kontrollit të këtillë. Respektivisht, rëndësia e këtyre terminëve nuk është e ndarë deri në fund. Prandaj, mbikëqyrja kundrejt kontrollit duhet të kuptohet si nocion i përgjithshëm kundrejt i posaçëm, gjegjësisht se mbikëqyrja përfshin mbikëqyrje të një sferë/rrethi më të gjerë nga kontrollimi. Kështu arrihet tek konkludimi se funksioni mbikëqyrës realizohet pa përzjerje të drejtpërdrejt/ të drejtpërdrejtë të organit që kryen mbikëqyrje në korrigjimin e punëve të ngatërruara në pozitë që sipas tij duhet të jenë, por vetëm tregon për të, pa ndërhyrje të drejtpërdrejtë. Ndërsa kontrolli, kontrollon sferë/rreth më të vogël të punëve, me mundësi për ndërhyrje të drejtpërdrejtë të kontrollorit dhe sjelljen e tyre në gjendje normale.³⁵

3.8. Të drejtat e drejtorit të falimentimit

Në nenin 146, alineja 1 qëndron se “*mbikëqyrja mbi realizimin e planit për riorganizim pas mbylljes së procedurës së falimentimit, mund t'i jetë besuar drejtorit të falimentimit ose personave tjerë (kontrollorëve).*”³⁶ Autorizimet të cilat i ka pasur drejtori i falimentimit me hapjen e procedurës së falimentimit, tani orientohen në kontrollimin e realizimit të planit të riorganizimit, gjegjësisht autorizimet bëhen më speciale, të cilat janë të drejtuara vetëm kah mbikëqyrja e subjektit në riorganizim dhe veprimi i tij në realizimin e planit. Duke u bazuar në këto autorizime ai ka të drejtë të kërkojë nga subjekti në riorganizim që t'ia lëshojë hapësirën e tij punuese dhe ti mundësojë qasje deri tek dokumentacionet e tërësishme në lidhje me realizimin e planit të riorganizimit. Me raporte të veçanta edhe atë më se paku një herë në vit, dhe kur ajo kërkohet ose sipas nevojës, me informacione të posaçme për realizimin e planit të riorganizimit, gjendjen financiare të subjektit, etj, duhet të lajmërojë edhe gjykatësin e falimentimit, këshillin e kreditorëve për mënyrën e realizon planin.

Nëse gjatë kontrollit drejtori i falimentimit konstaton se kërkesat nuk janë shlyer dhe është dashur që të shlyhen ose nuk mund menjëherë dhe pa vonesë të shlyhen, do ta njoftojë këshillin e kreditorëve dhe gjykatësin e falimentimit, dhe në rast se nuk është i formuar këshilli i kreditorëve, atëherë do t'i njoftojnë

³⁵ Brajanovski, B., Beliçanec, T. dhe Nikollovski, A. Komentari për Ligjin për falimentim, fq. 349

³⁶ Shiko: nenin 246 alineja 1 nga Ligji për falimentim, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë. Nr. 79/13

të gjithë kreditorët të cilat kanë të drejta të caktuara kundrejt debitorit ose shoqatës së porsaformuar/së re në pajtim me nenin 247 nga Ligji për falimentim.³⁷

3.9. Hapja e sërishme e procedurës së falimentimit

Personat të cilët mund të dorëzojnë propozim për hapje/ngritje të procedurës së re të falimentim ndaj subjektit për riorganizim janë: persona të autorizuar të kryejnë mbikëqyrje dhe secili kreditor me kërkesa të caktuara. Propozimi duhet të jetë i arsyeshëm dhe në të jenë të përmendura shkaqet se pse kërkohet hapje e sërishme e procedurës së falimentimit.

Karakteristika për hapjen/ngritjen e kësaj procedure qëndron në atë se nuk është domosdoshme që subjekti i riorganizimit të jetë insolvent/i paaftë për pagesë. Shkaqet përse nuk është realizuar plani për riorganizim do t'i hulumtojë gjykatësi i falimentimit. Por, nuk do të hapet/ngrihet procedurë e më përparshme për hulumtim të kushteve për hapje/ngritje të procedurës së falimentimit; do të mbahet seancë, pasi më parë do të merren deklarata nga propozuesi dhe nga subjekti i riorganizimit. Pra, duhet të përfundojmë se legjitimitet pasiv në këtë procedurë ka subjekti në riorganizim, e jo debitori ndaj të cilit është hapur/ngritur procedurë për falimentim.³⁸

³⁷ Neni 243 nga Ligji për falimentim, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/13 ,

³⁸ Kostovski, D. Ligji për falimentim-komentare, sqarime, praktikë gjyqësore dhe regjistër lëndësh. Akademik 2014, fq. 716

KAPITULLI 4

REZULTATET NGA ANALIZA E PASQYRAVE FINANCIARE

4.1 Historitë dhe statutet e ndërmarrjeve të falimentuara

4.1.1 Historia e "Shik Jelak" Tetovë

"Shik Jelak" Tetovë, fillon me punë me 01.01.1963 duke u bashkuar me " Bor " dhe " Jelak " – Tetovë. Në vitin 1987 Shik Jelakut i bashkangjitet fabrika e mobiljeve shkollore nga Krusheva dhe Korporata nga f.Radiovc..

Në vitin 1989 me sjelljen e Ligjit për shoqëritë, Shik Jelak Tetovë, shëndrohet në Shoqëri për prodhimin e mobiljeve, njësi punuese për tregtinë e mallrave dhe për menaxhimin e pyjeve.

Në vitin 1990 me sjelljen e Ligjit për shëndrimin e kapitalit të shoqërive, Shik Jelak regjistrohet si Shoqëri aksionare. Ky ndryshim zgjat deri në vitin 1998, ku shoqëria privatizohet 100% dhe të gjithë të punësuarit bëhen aksioner.

Shik Jelak i themelon shoqëritë në vazhdim :

- Shoqëria tregtare " Jelak Kushevo" - Tetovë , në vitin 01.01.2002.
- Shoqëria tregtare " Jelak Stolarija 2002" - Tetovë, në vitin 01.03.2002
- Shoqëria tregtare " Jelak Mebel 2002" - Tetovë, në vitin 01.03.2002
- Shoqëria tregtare " Jelak Dekor 2002" - Tetovë

Me vendim nga Regjistri Qendror, Shoqëritë tregtare " Jelak Kushevo" - Tetovë, " Jelak Stolarija 2002" - Tetovë, " Jelak Mebel 2002" - Tetovë, " Jelak Dekor 2002" - Tetovë, fshihen dhe përvetësohen në Shik Jelak SHA Tetovë.

Me vendim të Gjykatës Themelore Tetovë me Faliment.numër,119/09 nga 23.11.2009, hapet procedura e falimentimit e "Shik Jelak " Tetovë.

Struktura e pronësisë-

Sipas librit të aksioneve nga 27.07.2009 v. e paraqitur nga Regjistri qendror i letrave me vlerë në R.Maqedonisë, sturktura si në vazhdim :

1. Aksione të rëndomta të punësuarve - 77.920
2. Aksione me prioritet nga Fondi penzional invalidor - 0

Gjithësej = 77.920 aksione

Struktura e aksioneve : 656 aksioner.

Vlera nominale e një aksione arrijnë 3200 den. Kurse vlera nominale e përgjithshme e kapitalit arrijnë 249.944.000 den.

Struktura e kapitalit aksionar e dëshmon 100% strukturën private.

Në bazë regjistrimeve kontabël, evidentohet 2263 aksione me prioritet në SILEKS BANK - SHKUP me vlerë nominale prej 43.46 Euro. Vlera e përgjithshme nominale e këtyre aksioneve arrijnë 98.350 Euro apo 6.190.119 denarë me kurs të këmbimit të euros 61.2 den.

4.1.2 Historia e Tetks Yarn - Tetovë

Kompani për prodhimin e fijeve-pambukut si dhe te shitjeve te prodhimeve te tekstilit TETEKs Yarn DOEL-Tetove, është themeluar në baze te marrëveshjes për themelim me 12.07.2007 nga TETEKs SHA - Tetovë me numër tatimor : 4037537, SANDNES ULAVAREFABRIK nga Norvegjia me numër tatimor : 982771048, VIGO ERIKSEN HOLDING nga Norvegjia me numër tatimor : 982303583, nënshkruan marrëveshjen dhe filluan me punë me 01.08.2007, udhëheqësi është zgjedhur DUSHKO MISHEVSKI, udhëheqës me autorizim te pakufizuar, për shitjet brenda dhe jashtë vendi, me profesion inxhinier I diplomuar si dhe teknolog tekstili.

Me vendim të Gjykatës Themelore Tetovë me Faliment.numër,104/11 od 11.07.2011, hapet procedura e falimentimit e ‘‘Teteks Yarn ‘‘ Tetovë.

Struktura e pronësisë-

Në bazë të dhënave nga Regjistri Qendror i R. M (gjendja momentale) dhe dokumenteve nga arhivi i strukturës përbërëse të debitorit - kapitali përbëhet nga 3 (tre) pjesë, edhe atë :

- Depozita themelore e partnerit TETEKs SHA - Tetovë, përfshinë 33.333% nga kapitali i përgjithshëm, si depozitë të mjeteve themelore (jo monetar) me vlerë prej 21.410.900,00 den.

- Depozita themelore e partnerit SANDNES ULAVAREFABRIK - Norvegji, përfshinë 33.333% nga kapitali i përgjithshëm, si depozitë të mjeteve financiare (monetar) me vlerë prej 21.410.900 den.

- Depozita themelore e partnerit VIGO ERIKSEN HONDING - Norvegji, përfshinë 33.333% nga kapitali i përgjithshëm, si depozitë të mjeteve qarkulluese (monetar) me vlerë prej 21.410.900,00 den.

Në bazë të dokumenteve të fituara nga Regjistri qendror i letrave me vlerë, kjo shoqëri nuk është evidentuar si bartëse i letrave me vlerë.

Struktura e përbërëse e kapitali e dëshmon 100% strukturën private.

Në bazë regjistrimeve kontabël, nuk janë të evidentuara aksione tjera me të cilat do të përgjigjet.

4.2 Arsyet e falimentimit dhe masat që u ndërморën nga udhëheqësia për tejkalimin e së njëjtës.

4.2.1 Arsyet e falimentimit të “ SHA Shik Jelak “

Arsyet kryesore nga të cilat SHA Shik Jelak - Tetovë, hapi procedurën e falimentimit është paraqitja e humbjes së madhe të pambuluar gjatë aktivitetit të saj, kjo humbje është rezultat i shumë faktorëve (të jashtëm dhe të brendshëm),

Arsye kryesore të cilat e dërguan drejt hapit të falimentimit është humbja e lartë e pambuluar gjatë zhvillimit të aktivitetit të saj, kjo humbje e cila erdhi si rezultat i faktorëve të ndryshëm, të jashtëm dhe të brendshëm, të cilat e penguan në shfrytëzimin e të gjithë kapaciteteve të saja.

Si rezultat i kësaj, Shoqëria në mënyrë të vazhdueshme nga zhvillimi i aktivitetit të sajë ka akumuluar humbje të larta.

Humbjet e larta të bartura që janë treguar në llogaritë mbyllëse duke përfshirë edhe 23.11.2009 v., kur është hapur procesi i falimentimit, arrijnë vlerën 126.150,00 den., gjegjësisht 2.060,00 Euro.

Humbja e akumuluar paraqet humbjen e mjeteve financiare, që është arsye e rritjes së obligimeve afat shkurte ndaj furnitorëve dhe njërive tjera punuese, nga e cila maksimalisht është dëmtuar likuiditeti i sajë, që kjo çon në hapjen e procedurës së falimentimit.

4.2.2 Arsyet e falimentimit të “Teteks Yarn “

Arsye bazike e cila e solli këtë shoqëri në hapjen e procesit të falimentimit është Investimi, edhe atë sepse është investuar në kohë dhe vend të gabuar (makina), ku në fillim të vitit 2010 është investuar në blerjen e një makine, e cilat nuk i plotësonte nevojat për vazhdimin e prodhimit dhe gjithashtu nuk e arrijnë kapacitetin e nevojshëm për prodhim.

Gjithashtu arsye tjetër kryesore që shoqata arriti në jolikuiditet të madh është sepse themeluesit e huaj VIGO ERIKSEN HONDING - Norvegji dhe SANDNES ULAVAREFABRIK - Norvegji, nuk e pranuan vendimin e TETEKS - Tetovë për rritjen e çmimit të avullit, i cili përdorët gjatë procesit të prodhimit, nga 31 në 39 euro/ton, me të cilën shpenzimet mujore arrijnë rreth 25 deri më 31 mije € për sezonin dimëro, mirëpo themeluesit e jashtëm të cilët kishin shumicë në votim vendosën që avulli të prodhohej në mënyrë tjetër, me blerjen e një mjeti që prodhon avull, e i cili shpenzon derivatet të lehta të naftës, me qëllim që te investohet edhe në një mjet tjetër që do të shfrytëzohet në sezonin dimëror për

nxehe dhe të transferohet në shpenzime me qymyr.

Me 27.04.2010 SHA Teteks - Tetovë e ndërpreu prodhimin e avullit dhe kështu fabrika nuk punoi rreth 2 muaj edhe atë prej 28.04.2010 vj. deri më 19.06.2010 vj. Për këtë periudhë u bënë shpenzime fikse realisht të larta, rreth 180.000,00 euro, ku për 2 muaj pagat e punëtorëve akumuluan rreth 50.000,00 euro për muaj, qiraja për 2 muaj nga 35.000,00 euro plus TVHSH-ja, pa shpenzimet tjera dhe pa investimet që u realizuan për mirëmbajtjen e makinës , me vlerë prej më shumë se 92 000,00 euro, pikërisht nga fakti se kompania nuk ka pasur prodhim, ashtu edhe nuk ka realizuar profit. Pra për këto arsye debitori është vonuar në dorëzimin apo shpërndarjen e mallrave nga marrëveshjet e arritura më parë me konsumatorët e sajë dhe dënimet të cilat i erdhën në bazë të kësaj, shoqëria pësoi shpenzime shtesë.

Me fillimin e punës dhe me prodhimin e avullit nëpërmjet mjetit të blerë, ku furnizimi bëhej me derivatet të lehta të naftës në sasi 8,000 litra në ç' do të dytën ditë. Çmimi i derivateve të lehta të naftës në muajin Qershor arriti 38 denar pa TVSH. Me një llogaritje të lehtë mund të konstatojmë se shpenzimet mujore u rriten më tepër për 55.000,00 € për prodhimin avullit. Çmimi i cili çdo muaj po rritej dhe kështu që në muajin Dhjetor arriti 45 den pa TVSH me tendencë të rritjes së vazhdueshme të çmimeve, gjegjësisht çmimi i derivatet të lehta të naftës u rrit për më shumë se 20 % .

Kompania nuk do mund të ndiqte këtë tendencë të rritjes së çmimit të naftës, me ndryshimin paralel të çmimeve të produkteve ndaj konsumatorëve të saj.

Në anën tjetër, në këtë mënyrë është zvogëluar kapaciteti për krijimin e energjisë së nevojshme për prodhim, kështu që shumica e proceseve teknologjike nuk ka mundur të shfrytëzohen në të njëjtën kohë, që do të thotë më pak efektivitet në punë.

Prandaj duke krijuar edhe kosto shtesë, pasi që ka qenë e nevojshme që të punohet me tre ndërrime dhe njëkohësisht për shkak të mungesës së fondeve, dhe vetë procesi i punës ka hasur ndërprerje të vazhdueshme dhe është pritur shumë deri tek pagesat e blerësve, në mënyrë që të vazhdojë furnizimin me energjinë e nevojshme dhe rrjedhimisht me këtë të zgjerojë procesin e prodhimit.

Arsye tjetër që duhet të përmendet se pse kjo kompani arriti në falimentim, është fakti se procesi i shërbimit ndaj kompanisë SANDNES ULAVAREFABRIK nga Norvegji, edhe atë çmimi në shërbim për artikujt të cilët punoheshin për SANDNES , lëviznin nga 1 € për kg për lëndën e parë të bardhë, nga 2,55 € për kg për lëndën e parë me ngjyrë (90 % e lëndës së parë ishte e bardhë.)

VËREJTJE: Lënda e parë e SANDNES ULAVAREFABRIK nga Norvegji furnizohej me lagështi, pastaj dërgohej si fije e thatë dhe faturohej me peshë neto. Puna e rregullt nuk i mbulonte vetë shpenzimet e energjisë elektrike e ku edhe të fuqisë punëtore, këto çmimet e shërbimit shumë të ulëta drejtojnë dukshëm ndikojnë në rritjen e shpenzimeve për rreth 30 %.

Luhatjet e çmimeve të naftës, e dërguan kompaninë në një pozicion ku vazhdimisht ndryshonin kostot fikse të prodhimit, kështu që edhe çmimi përfundimtar i produkteve ndryshonte, nuk ishte i

qëndrueshëm që e cila ndikonte negativisht tek klientët, pra edhe plasimin e sigurt të produkteve në treg që e kishin u vendos përball një rreziku të madh.

Si rezultat i kësaj, shoqëria në mënyrë të vazhdueshme tregonte humbje të larta gjat vitit 2011, nga të cilat nuk arrinte që në kohë të shlyej detyrimet e saja ndaj furnizuesve.

Humbjet e larta të paraqitura nga listat mbyllëse me 11.07.2011, kur edhe është hapur procesi i falimentimit, arrijnë vlerën prej 52.295.249,00 denarë, të cilat të paraqitura në Euro arrijnë rreth 848.573,00 euro .

Humbja e akumuluar paraqet humbje të mjeteve financiare, që është rezultat i rritjes së detyrimeve ndaj klientëve të saj, e sidomos atyre afat shkurt, gjë e cila ka ndikuar në rritjen e jolikuiditetit, nga e cila firma ka pësuar proces të falimentimit.

4.3 Analiza financiare

4.3.1 Analiza e gjendjes financiare të “Shik Jelak “ - Tetovë

Analiza e gjendjes financiare të kësaj kompanie është e bërë duke u bazuar në Bilancin e gjendjes dhe Bilancit të suksesit. Është bërë analiza në strukturë dhe dinamike me treguesit financiar nga 7 vitet e fundit të punës së kompanisë (2003 - 2009)

Analiza e bilancit të gjendjes


Analiza e bilancit të gjendjes është realizuar duke përdorur treguesit kryesorë ,të cilat mundësojnë një pasqyrë më të pastër rreth gjendjes financiare të shoqërisë. Në vazhdim do të paraqes analizën dinamike(horizontale) të bilancit të gjendjes nga viti 2003 deri 2009.

Analiza horizontale e bilancit të gjendjes

Tabela Nr.1

Në mil. denarë.

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	24.09. 2009
Mjetet themelore	122.952	97.355	93.301	75.556	71.633	65.870	63.030
Mjetet qarkulluese	164.611	184.268	167.654	201.821	193.145	196.876	196.629
AVR	2.102	773	710	710	/	/	/
Gjithsej							
Aktiva	289.665	282.396	261.665	278.087	264.778	262.746	259.659
Kapitali dhe rezervat	229.088	216.104	193.001	186.155	162.914	136.465	120.248
Detyrimet afatgjate dhe afatshkurte	60.520	66.235	68.664	91.932	101.864	125.669	138.799
PVR	57	57	/	/	/	612	612
Gjithsej							
burimi i mjeteve	289.665	282.396	261.665	278.087	264.778	262.746	259.659



Burimi : Përlllogaritje nga vet autori.

Në bazë të dhënave tabelare dhe grafike nga Balanci i gjendjes të viteve 2003-2009 mund të vërejmë se mjetet themelore kanë një rënie të vazhdueshme ku nga 122.952.000,00 denarë në vitin 2003 arrijnë në 63.030.000,00 denarë në 24.09.2009. Gjithashtu edhe kapitali dhe rezervat të cilat në vitin 2003 arrijnë vlerën prej 229.088.000,00 denarë, kurse në vitin 2009 ata janë zvogëluar në 120.248.000,00 denarë.


Kurse në anën tjetër mund të vërejmë rritje të vazhdueshme nga viti në vit të Detyrimeve afatgjate dhe afat shkurte, të cilat në vitin 2003 ishin rreth 60.520.000,00 denarë, kurse në vitin 2009 u rritën në 138.799.000,00 denarë, që na jep një sinjal negativ të gjendjes financiare të kompanisë. Mund të themi se me kalimin e kohës në kompani paraqiten probleme me likuiditetin dhe solventitetin. Problem tjetër i rëndësishëm shfaqet edhe burimi joadekuat i mjeteve, e cila është sqaruar në tabelën në vazhdim.

Tabela Nr.2

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	24.09 .2009	23.11. 2009*
Kapitali dhe rezervat	79 %	77%	74%	67%	62%	52%	46,6%	23,9%
Detyrimet afatgjate dhe afat shkurte	21%	23%	26%	33%	38%	48%	53,4%	76,1%
Gjithsej burimi i mjeteve	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Në bazë të strukturës së burimeve të mjeteve mund të evidentohen problemet me të cilat ballafaqohet kompania, ku para se gjithash qëndron fakti se pjesën më të madhe të aktivitetit të saj e financon nga detyrimet afatgjate dhe afatshkurta.

Struktura e burimeve të mjeteve me 23.11.2009.



urimi : Përlllogaritje nga vet autori

Për të pasur një pasqyrë të vërtetë për gjendjen para hapjes së procedurës së falimentimit në të cilën ndodhej kompania, kam analizuar bilancin e gjendjes me 23.11.2009 dhe me ndihmën e treguesve financiar.

Tabela Nr.3 **Bilanci i gjendjes**

	23.11.2009
Mjetet themelore	263.559
Mjetet qarkulluese	81.187
AVR	/
Gjithsej aktiva	317.746
Kapitali dhe rezervat	76.176
Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjate	240.758
PVR	812
Gjithsej pasiva	317.746

Në bazë të bilancit të gjendjes me datë 23.11.2009, mund të konstatojmë gjendjen e alarmante financiare në të cilën ndodhej shoqëria, ku neto kapitali i punës arrijnë vlerën - 159.971 (81.187 - 240.758), që paraqet një sinjal të pamundësisë së shoqërisë, që ti'u përgjigjet detyrimeve me mjetet e saja. Treguesi i likuiditetit me 23.11.2009 arrijnë 0.34 (81.187/240.758) dhe nëse merret parasysh fakti se ky tregues tek kompanitë likuide duhet të jetë 1 ose më i madh se 1, mund të konstatohet se kjo kompani është jolikuide, gjegjësisht nuk është e aftë që ti mbulojë obligimet e saja me mjetet e saja.

4.3.2 Analiza e gjendjes financiare të “Tetks Yarn “ – Tetovë

Analiza e gjendjes financiare të kësaj kompanie është e bërë duke u bazuar në Bilancin e gjendjes dhe Bilancit të suksesit. Gjithashtu duke u bazuar në raportet financiare, duke llogaritur treguesit kryesorë financiarë, në periudhë prej vitit 2007 deri në vitin 2010.

Është bërë analiza në strukturë dhe dinamike me treguesit financiar nga 4 vitet e fundit të punës së kompanisë(2007-2010). Pasqyrat financiare paraqesin pasqyrat e gjakut të funksionimit të një shoqërie, prandaj të gjitha anomalitë të një shoqërie të dallohen përmes analizës së raporteve financiare. Përmes analizës financiare përfitohen informacione rreth pozitës financiare, performancës, ndryshimet e kapitalit, likuiditetit, etj. Analiza në vazhdim do të përfshijë Analizën e bilancit të gjendjes dhe atë të suksesit, gjegjësisht përfshinë analizën horizontale të bilancit të gjendjes për tu parë lëvizja (ndryshimi i zërave bilancor), analizën vertikale të bilancit të gjendjes (për tu parë përfshirja e zërave të caktuar, në aktive dhe pasivë, e cila do të mundësojë vlerësimin e vendosjes së mjeteve dhe burimeve të mjeteve, gjegjësisht për të verifikuar nëse ekziston ndonjë anomali në strukturën e bilancit. Bilanci i suksesit analizohet përmes lëvizjes së të hyrave dhe trendit të akumulimit të rezultatit financiarë (fitimit / humbjes) për të

përcaktuar forcën e të hyrave të kompanisë.

Analiza e bilancit të gjendjes

Në kuadër të analizës së bilancit të gjendjes, do të bëj analizën horizontale dhe atë vertikale (analiza në strukturë), të 4 viteve të fundit të funksionimit të shoqërisë (2007 - 2010 v.).

Analiza horizontale e bilancit të gjendje

Tabela Nr.4

	2007	2008	Ndryshimi	2009	Ndryshimi	2010	Ndryshimi
Mjetet themelore	40.396	40.971	1,43%	37.939	-7,4%	50.508	33%
Mjetet qarkulluese	84.079	118.090	40,5%	161.238	36,5%	301.681	87%
Mallërat	31.916	52.183	63,5%	50.490	-3,3%	118.757	135%
Kërkesat ndaj blerësve	35.182	48.331	37,3%	109.437	126%	182.889	67,1%
Paratë e gatshme dhe letrat me vlerë	16.981	17.576	3,5%	1.309	-92%	24	-98%
Gjithsej Aktiva	124.476	159.061	27,8%	199.177	25,2%	352.189	77%
Kapitali dhe rezervat	76.785	78.409	2,12%	75.051	-4,3%	54.390	-28%
Detyrimet afatshkurtra	47.535	80.571	69,5%	123.803	54%	254.741	105%
Gjithsej Pasiva	124.476	159.061	27,8%	199.177	25,2%	352.189	77%

Në bazë të dhënave tabelare, duke analizuar aktivën e bilancit të gjendjes, mund të konstatojmë se në 4 vitet e fundit nuk vërehen ndryshime domethënëse të mjeteve themelore, rritje të konsiderueshme në këtë pozicion regjistrohen në vitin 2010, ku pas rënies në vitin 2009, sërish shënoj rritje prej 33%. Rritje kjo e cila është e kuptueshme, duke pasur parasysh faktin se kompania arrinte fitim në vitet e mëparshme.

Mjetet qarkulluese në krahasim me Mjetet Themelore, kanë trend të rritjes si rezultat i rritjes së kërkesave ndaj blerësve dhe gjithashtu edhe të mallrave. Gjegjësisht, siç u cek edhe më lartë, pas viteve të suksesshme, kjo e cila rezulton edhe me rritjen e inventarëve (mallrave) rreth 118.757.000 den., të cilat njihen si aktive më pak likuide, duke e rrezikuar likuiditetin aktual të kompanisë.

Përveç asaj që thamë më lartë, akumulimin e niveleve të larta të rrezikut në strukturën financiare, përmes rritjes graduale të rritjes së leverixhit, gjegjësisht krijimin e një strukture financiare, ku pjesëmarrje dominante kanë detyrimet, pra krijon një imazh negativ për kompaninë dhe dëshmon për uljen e likuiditetit dhe paqëndrueshmërisë financiare. Ku nga tabela mund të vërejmë rritje të vazhdueshme të detyrimeve, të cilat nga viti 2007 me 47.535.000 den. arrijnë që në vitin 2010 të kapin vlerën rreth 254.741.000 den., që nënkupton nga 38% arrijnë në 72% pjesëmarrja e obligimeve në pasivë.

Analiza vertikale e bilancit të gjendjes

Tabela Nr.5

	2007	2008	2009	2010
Mjetet themelore	32,5%	25,8%	19%	14%
Mjetet qarkulluese	67,5%	74,3%	80%	85%
Mallërat	25,6%	33%	25,3%	33%
Kërkesat ndaj blerësve	28%	30%	55%	52%
Paratë e gatshme dhe letrat me vlerë	13%	11%	0,66%	0,01%
Gjithsej Aktiva	100%	100%	100%	100%
Kapitali dhe rezervat	61,7%	49%	38%	15%
Detyrimet afatshkurtra	38,3%	51%	62%	85%
Gjithsej Pasiva	100%	100%	100%	100%

Në bazë të analizës vertikale (në strukturë), mund të konstatojmë se kompania ka anomali në përbërjen e pasivës, gjegjësisht në burimet e mjeteve nga 2008 deri 2010.

Në vitin 2010 kompania akumulon nivel të lartë të detyrimeve, duke krijuar burime të mjeteve kryesisht të bazuara në detyrime, gjegjësisht kompania financohet 85% me borxh dhe vetëm 15% me burime të veta. Strukturë e tillë financiare, klasifikohet si strukturë me rrezik të lartë, ku për të qenë një strukturë të qëndrueshme do të duhej që burimet e mjeteve të llogariten rreth 50%.

Nëse do të analizonim aktivën e bilancit të gjendjes, do të vërejmë se bëhet fjalë për kompani prodhuese, megjithatë pjesëmarrje dominante kanë mjetet qarkulluese, nga të cilat një pjesë e vogël janë para të gatshme dhe aktive likuide nga të cilat do të mund të shlyheshim detyrimet afat shkurte të akumuluar. Lidhja mes aktiveve jolikuide dhe akumulimit të detyrimeve afat shkurta, pagesa e të cilave është vendosur në pikëpyetje për shkak të uljes së likuiditetit, të cilat në masë të madhe ndikojnë në paaftësinë e kompanisë në vazhdimin e aktivitetit normal të kompanisë.

Analiza e bilancit të suksesit të “ Shik Jelak “ - Tetovë


Në vazhdim është paraqitur tabela e bilancit të suksesit nga viti 2003 deri në 24.09.2009 v.

Tabela Nr.6

Në mil. denarë

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	24.09. 2009
Të hyrat	47.288	39.209	4.118	29.405	12.712	4.721	2.286
Shpenzimet	55.996	50.733	27.222	35.901	35.613	29.196	18.504
<i>Humbja</i>	8.708	11.524	23.104	6.496	22.901	24.475	16.218


Nga tabela mund të konstatojmë se të hyrat që nga viti 2003 në mënyrë ta vazhdueshme kanë qenë rënëse, edhe atë nga 47.288.000,00 den. Kanë rënë në 39.209.000,00 den. Në vitin 2004. Ulje më e madhe vërehet në vitin 2005 në vlerë 4.118.000,00 den., pastaj ka hasur rritje të të hyrave si rezultat i shitjes të disa pjesëve ndërtimore dhe tokave të cilat i posedonte, kjo vërehet në Bilancin e gjendjes të vitit 2006 të dorëzuar në Regjistrin Qendror, ku nga viti 2005 Aktivet afatgjate janë në vlerë 93.300.811,00den, ndërsa pas shitjes, në vitin 2006 Aktivet afatgjate evidentohen me vlerë prej 75.555.991,00 den. Dhe pas kësaj në vitet në vazhdim, gjegjësisht, në vitet 2007, 2008 dhe 2009 gjithmonë kanë pasur ulje, të cilat në vitin 2009 arrijnë vlerën 2.286.000,00 den.



Burimi : Përlllogaritje nga vet autori

Ndërsa nëse do të shohim shpenzimet do të vërejmë ulje, si rezultat i uljes së aktivitetit të ndërmarrjes, kurse ulja më e shpejtë e të hyrave nuk ofron mundësi të akumulimit të rezultateve pozitive.

Nënkuptojmë se ndërmarrja që nga viti 2003 në mënyrë të vazhdueshme ka akumuluar humbje, e cila në vitin 2003 arrijnë vlerën prej 8.708.000,00 den. dhe në vitin 2009 humbja bëhet më e madhe deri 16.128.000,00 den. Humbje më të ulët ka pasur në vitin 2006, me vlerë prej 6.496.000,00 den. Si rezultat i rritjes të së hyrave të akumuluar nga shitja e aseteve fikse, kurse në anën tjetër humbje më e madhe vërehet në vitin 2008 me vlerë prej 24.475.000,00 denarë.



Burimi : Përlllogaritje nga vet autori

Analiza e bilancit të suksesit të “ Teteks Yarn “ - Tetovë

Analiza e bilancit të suksesit bëhet me qëllim të përfitimit të rezultateve të ndërmarrje, edhe atë në katër vitet e fundit (2007 - 2010v.), gjegjësisht që të shikohet relacioni i të hyrave dhe shpenzimeve dhe lëvizja e rezultateve financiare.

Tabela Nr.7

	2007	2008	2009	2010
Të hyrat	96.841	274.751	232.648	292.372
Shpenzimet	82.681	268.305	230.579	342.830
Humbja/Fitimi	12.552	5.359	254	(20.661)

Nëse shikojmë Bilancin e suksesit nga viti 2007 deri vitin 2010, mund të vërejmë se ndërmarrja ka akumuluar rezultate financiare pozitive. Fitimin të cilin akumulon katër vitet e fundit ka trend rënës, e cila nga viti në vit fitimi është më i vogël, ku në vitin 2010 ndërmarrja akumulon rezultat financiar negativ, gjegjësisht humbja arrijnë vlerën prej 20.661.000,00 den. Tek të hyrat mund të konstatojmë se ato janë relativisht të qëndrueshme, megjithatë nuk mund të reflektojnë në krijimin e rezultateve financiare pozitive, për arsye se ndërmarrja në mënyrë të vazhdueshme i rrit shpenzimet e saja, gjegjësisht ndërmarrja është jofitimprurëse.

Nga katër vitet e analizuara, në vitin 2010 ndërmarrja akumulon të hyra më të larta dhe të njejtat në krahasim me një vit më parë rriten për 25.6%, megjithatë në të njejtin vit ndërmarrja realizon shpenzime pothuajse dy herë më të larta në krahasim me të hyrat , ku të shpenzimet rriten për 49% në krahasim me vitin e kaluar, kjo rritje i adresohet shpenzimeve në lëndën e parë.

4.4 Analiza në bazë të koeficienteve financiarë të “ Teteks Yarn “ dhe “ Shik Jellak ”

Vetëm analiza e treguesve financiarë të raporteve financiare, gjegjësisht analizat vertikale dhe horizontale të Bilancit të gjendjes dhe të suksesit, nuk mundemi qartë të paraqesim dhe sqarojmë pasqyrën reale të gjendjes financiare të ndërmarrjes, sepse nuk na ofrojnë informacionet e nevojshme për të kuptuar bonitetin e ndërmarrjes, por japin vetëm sinjale rreth disa anomalive të saj. Prandaj në vazhdim do të paraqesim analizat e pasqyrave financiare, ku do të përfshijmë indikatorët për përcaktimin e likuiditetit, borxhit dhe profitabilitetit, të cilat janë të përlogaritura për katër vite.

Tabela Nr.8

Teteks Yarn :

Treguesit	2007	2008	2009	2010
Likuiditeti - Raporti Korrent	1,76	1,46	1,30	1,1
Likuiditeti - Raporti i shpejtë	1.09	0.81	0.89	0.71
Borxhi	38%	50%	62%	72%
Profitabiliteti	12,9	1,9	0,11	n/a

Tabela Nr.9

Shik Jelak :

Treguesit	2005	2006	2007	2008
Likuiditeti - Raporti Korrent	2.44	2.20	1.90	1.57
Likuiditeti - Raporti i shpejtë	2.25	2.07	1.78	1.56
Borxhi	26%	33%	38%	49%

4.4.1 Likuiditeti**Teteks Yarn :**

Raporti korrent = Aktive afat shkurte / Detyrimet afat shkurte :

$$2007 = 84.079.000 / 47.535.000 = 1.76$$

$$2008 = 118.090.000 / 80.571.000 = 1.46$$

$$2009 = 161.238.000 / 123.803.000 = 1.30$$

$$2010 = 301.681.000 / 254.741.000 = 1.18$$

Shik Jelak:

Raporti korrent = Aktive afat shkurte / Detyrimet afat shkurte :

$$2005 = 167.654.677 / 68.663.935 = 2.44$$

$$2006 = 201.820.913 / 91.931.851 = 2.20$$

$$2007 = 193.145.348 / 101.864.848 = 1.90$$

$$2008 = 196.875.740 / 125.668.776 = 1.57$$

Raporti Korrent lidh aktivet afatshkurta me pasivet afatshkurta me njërin tjetrin. Ky raport duhet të jetë të paktën 2 : 1 në mënyrë që të konsiderohet si i mjaftueshëm, kurse një raport poshtë 2:1 na paralajmëron risk të mundshëm likuiditeti.

Nga kjo analizë mund të kuptojmë edhe rreth kapitalit punues të ndërmarrjes. Kapitali punues është një nga treguesit më të rëndësishëm dhe domethënës së analizës së likuiditetit të një njësie ekonomike. Kur detyrimet afatshkurtra tejkalojnë aktivet afatshkurtra, atëherë kemi mungesë në kapitalin punues, kurse kur aktivet afatshkurtra tejkalojnë detyrimet afatshkurtra , atëherë paraqitet tepriçë e kapitalit punues, që tregon se në ç'masë ndërmarrja ka përdorur financimin afatgjatë në investime afatshkurtra, që rastin tonë kemi tepriçë të kapitalit punues.

Teteks Yarn:

Raporti i shpejtë = Aktive afat shkurte - Inventarët / Detyrimet afat shkurte:

$$2007 = 84.079.000 - 31.916.000 / 47.535.000 = 1.09$$

$$2008 = 118.090.000 - 52.183.000 / 80.571.000 = 0.81$$

$$2009 = 161.238.000 - 50.490.000 / 123.803.000 = 0.89$$

$$2010 = 301.681.000 - 118.757.000 / 254.741.000 = 0.71$$

Shik Jelak:

Raporti i shpejtë = Aktive afat shkurte - Inventarët / Detyrimet afat shkurte:

$$2005 = 167.654.677 - 13.169.084 / 68.663.935 = 2.25$$

$$2006 = 201.820.913 - 11.912.420 / 91.931.851 = 2.07$$

$$2007 = 193.145.000 - 11.912.770 / 101.864.848 = 1.78$$

$$2008 = 196.875.740 - 12.950.593 / 125.668.776 = 1.56$$

Raporti i shpejtë përfshinë në numërues vetëm ato klasa të atkiveve afatshkurta të cilat priten të kthehen në “para” sa më shpejtë, pra vetëm klasat me aktivet afatshkurte më likuide. Pra nëse ky raport ka një vlerë më të madhe se “1” është pothuajse e sigurtë se ndërmarrja është në gjendje të mbulojë detyrimet e saja duke përdorur aktivet likuide. Duke parë rezultate e përfituara nga ky raport mund të konstatojmë se ndërmarrja në fjalë, pra Teteks Yarn, ka koeficient negativ, që nënkupton investim të lartë në inventarë, gjegjësisht në lëndën e parë, e cila shkaktoi edhe rritjen e shpenzimeve, siç e cekëm më lartë tek tabela e humbjes dhe fitimit, kjo tregon investim jo adekuat dhe jofitimprurës.

Edhe pas llogaritjes së raporteve të likuiditeti nuk jemi të sigurt nëse likuiditeti i ndërmarrjes është e dobishme apo jo. Kjo ndodh për dy arsye që lidhen me cilësinë e vet raporteve si matëse të likuiditetit.

Së pari, megjithëse rezultatet e larta të raportit korrent dhe për raportin e shpejtë sugjerojnë një pozicion likuid të konsoliduar, ata gjithashtu mund të sugjerojnë edhe faktin që një sasi e tepërt e parasë është investuar në mënyrë jo fitim prurës në formën e aktiveve afatshkurtra, duke penguar investimin e parasë në forma tjerra më fitimprurëse.

Së dyti, në një situatë inflacioniste, investimet e larta në aktive afatshkurtra ku bëjnë pjesë : mjetet monetare, investimet afat shkurte, shpenzimet e parapaguara, llogarit e arkëtueshme, inventar, do të çojnë në humbje të larta monetare, gjë të cilën ndërmarrjet do të donin që t'iu shmangen në situata inflacioniste - pozicionet aktive të shoqërive sjellin humbje monetare, kurse pozicionet pasive në bilanc sjellin fitime.

4.4.2 Borxhi

Ashtu edhe siç e kemi cekur edhe me parë, e kemi konfirmuar se bëhet fjalë për dy ndërmarrje me shumë borxhe, tek të cilat është një ndër arsyet e hapjes së procedurës së falimentimit. Në rastin e Teteks Yarn nga tabela më sipër mund të konstatojmë se borxhet kanë trend të rritjes së vazhdueshme edhe atë nga viti 2007 ku borxhet arrijnë rreth 38%, në 2008 burimi i financimit është me borxh rreth 50%, dhe në vazhdim në vitin 2009 arrijnë në 62% dhe në 2010 rreth 72%, këto përqindje janë të larta dhe të rrezikshme për të ardhmen e ndërmarrjes. I njejt trend i rritjes së vazhdueshme të financimit nga borxhet është edhe tek ndërmarrja Shik Jelak, ku nga viti 2005 përqindja e borxhit është 26% dhe nga viti në vit rritet, ku në vitin 2008 arrijnë në 49%.

4.4.3 Profitabiliteti

Nëse do të shikojmë koeficientin e profitabilitetit mund të vërejmë një rënie, të thellë dhe të vazhdueshme nga viti në vit. Në vitin 2007 ndërmarrja ka punuar duke gjeneruar profitabilitet pozitiv prej 12.9 dhe më pas ka pasur rënie dramatike të profitabilitetit dhe lehtë mund të konstatohet se bëhet fjalë për ndërmarrje joprofitabile, për shkak të akumulimit të një rezultati negativ në vitin 2010 koeficienti nuk mund të llogaritet.

Nga analizat e koeficienteve të pasqyrave financiare të përlllogaritura, tek Teteks Yarn mund të themi se problemet e para janë paraqitur në vitin 2009, të cilat thellohen në vitin 2010 dhe që tregojnë jo likuiditetin e ndërmarrjes, me borxhe të thella dhe jo profitabile. Ndërsa tek Shik Jelak vitet e para të krizës janë paraqitur në vitin 2005 me një rezultat të thellë negativ dhe kanë vazhduar edhe në vitet e ardhshme. Rezultate të tilla nuk justifikohen ekonomikisht.

4.5 Analiza e tri modele të bankrotit: Altman Z-rezultati, Konan - Holder dhe Taffler

Shëndeti financiar është një shqetësim i rëndësishëm për vazhdimin e funksionimit të një shoqërie. Llogaritë e humbjes dhe fitimit na ofrojnë të dhëna rreth operimit të aktiviteteve të organizatës, kurse bilancet na tregojnë rreth aktiveve dhe detyrimeve të biznesit në një kohë të caktuar. Shëndeti financiarë varet nga aftësia paguese e organizatës ,e cila duhet të menaxhohet në mënyrë efikase në mënyrë që të sigurojë rritje sistematike dhe të vazhdueshme të sajë. Ekziston nevoja për mjete pro aktive dhe jo mjete reaktive për qasjen e përgjithshme të zbulimit dhe rregullimit të problemit të mundshëm.

Në thelb dallohen dy palë të interesuara për shëndetin financiarë të organizatave.

Ata klasifikohen në shfrytëzues të jashtëm dhe të brendshëm të informacioneve kontabël. Palët të cilat janë të interesuara për performancën e organizatës janë aksionarët, menaxherët, të punësuarit dhe auditorët e brendshëm. Palët e jashtme emërohen bankat, konsumatorët, kreditorët dhe furnizuesit. Aksionarët i përdorin informatat e kontabilitetit për të blerë, shitur apo për të sjell vendime lidhur me aksionet, obligacionet, etj. Kreditorët siç janë bankat, furnitorët i shfrytëzojnë informacionet kontabël për të marrë vendime të kreditimi dhe të dinë për aftësinë e pagesave të detyrimeve. Kështu, matja e performancës apo e shëndetit financiarë të organizatës ndikon në vendimet e tyre.

Ekzistojnë një larmi e gjerë e teknikave për matjen e shëndetit financiarë. Megjithatë, Altman Z-score është një model i vërtetuar dhe i besueshëm që parashikon mundësitë e falimentimit të shoqatave prodhuese , duke monitoruar dhe konsoliduar efektin e të gjithave raporteve financiare. Sipas të dhënave botërore evidentohet se ky model ka saktësi 76,9% në parashikimin e mundësisë së falimentimit (Beglez et al.1996). Altmani (1968) përcakton parashikimin e pesë faktorëve të cilat mund të testojnë vlefshmërinë e modelit të shumëllojshëm. Modeli bazohet në raportet financiare. Duke i përdorur raportet financiare parashikimi i falimentimit mund të jetë i saktë deri në 90% (Chen &Shemerda, 1981).

Modeli Z score është një produkt i analizës lineare, në të cilin 5 tregues ponderohen dhe përmbliidhen me një rezultat të përgjithshëm i cili është bazë për klasifikimin e njësive ekonomike në të dështuara apo

jo të dështuara. Vlen të theksohet se për variabla që nuk paraqitën interes në nivelin e analizës një variable, në nivelin e MDA ndodh e kundërta dhe anasjelltas.³⁹

Për shembull, indeksi që tregoi fuqinë më të madhe parashikuese të falimentimit i përzgjedhur nga modeli i analizës një variable të Beaver (1966), Fluksi i mjeteve monetare / Totali i detyrimeve⁸, nuk u përfshi në modelin Z score. Qëllimi i Altman nëpërmjet MDA ishte kërkimi i variablave të pavarura të cilat së bashku do të kontribuonin në masë të madhe në aftësinë parashikuese të modelit, pa shfaqur domosdoshmërisht rëndësinë më të madhe statistikore, kur analizohen veçmas (p.sh. si në analizën një variable).⁴⁰

Modeli Altman ishte fillimi i përdorimit të metodës MDA në studimin e parashikimit të falimentimit. Metodologjia statistikore që zbatoi kishte kritika të ndryshme. Moyer (1977) hodhi dyshime në aftësinë parashikuese të modelit dhe Deakin (1976) qëndroi në supozimin e normalitetit shumë variabëlsh, që zakonisht shkelej, me rezultat teste të rëndësisë dhe vlerësime të gabimeve të njëanshëm. Megjithatë, nuk u dyshua në aspektin teorik, prandaj dhe formoi bazën për shumë studime të ngjashme, duke kryesuar deri në vitet '80. Vlen të theksohet se modeli Z score është përdorur si plotësues (si variabël i pavarur) dhe në kërkimet me përmbajtje të ndryshme (nga parashikimi i falimentimit) si diagnostifikimi i pasqyrave financiare të falsifikuara (Falsified Financial Statements) Spathis (2002).⁴¹

³⁹ Balcaen, S. , Ooghe,H., (2006), 35 years of studies on business failure : an overview of the classic statistical methodologies and their related problems, The British Accounting Review, 38 , fq. 66,

⁴⁰ Beaver, W., (1966), Financial Ratios as Predictors of Failure, Empirical Research in Accounting: Selected Studies 1966, Journal of Accounting Research 4, fq. 74,

⁴¹ Spathis, C.,T. (2002) Detecting false financial statements using published data: Some evidence from Greece, Managerial Auditing Journal 17/4 , fq.186

Në vazhdim është zbatuar modeli Altman Z-score, duke u bazuar në raportet vjetore nga 2007-2010v. të paraqitura nga ana e shoqatës Tetek Yarn dhe Shik Jelak.

$$Z_i = 1.2x_{1i} + 1.4x_{2i} + 3.3x_{3i} + 0.6x_{4i} + 1x_{5i}$$

Ku

x_{1i} - kapitali punues në raport të aktivës totale. Kapitali punues paraqet dallimin mes Aktiveve afat shkurte dhe Detyrimeve afat shkurte, kurse totali i asetëve paraqet shumën e aktives afat shkurte dhe aktives afatgjate.

x_{2i} - fitimi i akumuluar në raport me Aktivën totale. Ky raport tregon sasinë e ri investuar, d.m.th paraqet shkallën që asetet janë paguar nga fitimet e kompanisë. Shoqëritë të cilat kanë fitimin e akumuluar më të lartë se Aktiva totale, nënkupton që asetet e tyre janë financuar nga fitimet e kompanisë dhe jo nëpërmjet të borxheve.

x_{3i} - Fitimi para tatimit dhe taksave në raport me aktivën totale. Kjo tregon fuqinë e akumulimit të fitimit të kompanisë.

x_{4i} - Raporti i kapitalit ndaj totalit të detyrimeve. Ky raport mat aftësinë paguese të kompanisë.

x_{5i} - shitjet neto në raport me Aktivën totale. Ky raport nga shitja zbulon aftësinë e gjenerimit të asetëve të kompanisë dhe gjithashtu ndryshon nga një industri në tjetrën.

4.5.1 Rezultatet e përfituara nga zbatimi i modelit të Altman Z-score:

Firmat të cilat kanë rezultat më të madh se 2.99 trajtohen si kompani që kanë performancë të mirë financiare dhe që janë jashtë rrezikut të bankrotit.

Ndërsa firmat të cilat kanë rezultat në mes 1.81-2.99, definoohen si firma që janë në zonën e injorimit apo në zonën e përhimt. Ajo gjithashtu tregon performancë të dobët financiare.

Ndërsa nëse Z-rezultati është më i pak se 1.8, atëherë kjo tregon performancë të ulët financiare, që informon se kompania është në zonën e rrezikut.

Përlllogaritja e Altman Z-score për periudhën 2007-2010 të Tetek Yarn, prezantohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr.10

Vitet	1.2	X1	1.4	X2	3.3	X3	0.6	X4	1	X5	Z rezultati
2007	1.2	0.2935	1.4	0.0857	3.3	0.1151	0.6	0.9706	1	0.7794	2.2142
2008	1.2	0.3794	1.4	0.0436	3.3	0.0405	0.6	0.9581	1	1.7358	2.9609
2009	1.2	0.3026	1.4	0.0515	3.3	0.0018	0.6	0.9953	1	0.3209	1.3595
2010	1.2	0.0636	1.4	0.0298	3.3	-0.0586	0.6	0.9953	1	0.9362	1.4581

Rezultatet e përfituara nga ky model tregojnë se kompania ka pasur luhatje të Z - rezultatit, që d.m.th. performanca të ndryshme financiare nga viti në vit, edhe atë në vitin 2007 shihet se performancat financiare edhe atë: kapitali i punës në raport të aktivës totale X1 në vitin 2007 ka qenë me performanca pozitive deri në fund të vitit 2009, kështu që në vitin 2010 kemi ulje drastike të kapitalit punues në raport të aktivës totale X1 që arrijnë nën 0.0636 që nënkupton se detyrimet afat shkurte janë shumë më të mëdha se aktivet afat shkurte, ndërsa sa i përket fitimit të akumuluar në raport me Aktivën totale apo X2 gjithashtu kemi ulje drastike nga viti në vit, ku nga viti 2007 e deri në vitin 2010 asetet kanë pësuar ndryshime, ku deri në vitin 2009 shumica e asetëve janë të financuar nga fitimi i akumuluar ndërsa në vitin 2010 asetet nuk janë financuar nga fitimi i akumuluar sepse humbja është rritur dhe asetet janë financuar nga borxhet e kompanisë.

Sa i përket X3 fitimit para tatimit dhe taksave në raport me aktivën totale shihet qartë se ndërmarrja në vitin 2007 ka pasur një fuqi shumë të lartë të akumulimit të fitimit në kompani edhe atë 0.1151, me tendencë të rënies nga viti në vit ku shihet se deri në vitin 2009 kompania ka qenë likuide, ndërsa në vitin 2010 koeficienti i fuqisë së akumulimit të fitimit në kompani zvogëlohet deri në -0.0586 që do të thotë paraqitet humbje e madhe në vitin 2010 në krahasim me vitet paraprake.

Sa i përket raportit të kapitalit ndaj detyrimeve totale - X4 shihet se ndërmarrja nga viti 2007 e deri në vitin 2008 detyrimet janë të paguara në intervale kohore të mjaftueshme apo të tolerueshme në ndërmarrje, ndërsa nga viti 2009- 2010 intervali kohor i kryerjes së obligimeve është rritur dhe arrijnë koeficientin 0.9953 me tendencë të rritjes më të madhe. Sa i përket shitjes neto në raport me aktivën totale - X5 shihet qartë se ndërmarrja nga viti 2007 e deri në vitin 2008 ka pasur rritje drastike pozitive, ndërsa nga viti 2009, X5 filon të bjerë në vitin 2010, por gjithashtu arrijnë koeficientin pozitiv edhe atë 0.9362 që është më i lartë se në vitin 2007, që do të thotë edhe në momentin e zvogëlimit të likuiditetit shitja ka

qenë e mjaftueshme, mirëpo rritja e shpenzimeve në vitin 2010 do të ndikojë në uljen e likuiditetit të ndërmarrjes.

Nga e gjithë kjo fitojmë Z - rezultatin të performancave financiarë. Nga tabela e lartë përmendur vërejmë se në vitin 2007 rezultati Z - rezultati i performancave financiare arrijnë 2.2142, që do të thotë se nëse Z - rezultati është në interval nga $1.22 < 2.9$ që është zona përhimt ku mund të paraqitet ndonjë dështim brenda vitit, kështu që në vitin 2008 kjo kompani arriti rezultatin Z më të lartë me performanca pozitive financiare edhe atë 2.67, ku shihet qartë se ndërmarrja nuk ka ndonjë rrezik për dështim.

Gjithashtu rezultatet e përfituara nga ky model tregojnë se kompania ka pasur luhatje të rezultatit Z, edhe atë nga viti 2007 dhe 2008 me Z-rezultat 2.21 gjegjësisht 2.9, gjë që e radhitën kompaninë në kompani që janë në zonën e përhimt me performancë të dobët financiare. Nga viti 2007 deri në vitin 2008 kemi rritje të mjeteve qarkulluese në krahasim me mjetet themelore, kjo vjen si pasojë e rritjes së kërkesave ndaj blerësve dhe gjithashtu edhe të mallrave. Ndërsa në vitin 2009 kemi ulje drastike të koeficienteve financiare edhe atë deri në 1.3595, që vazhdojnë edhe në vitin 2010, ku Rezultati Z arrin performancat financiarë me koeficient 1.4581, pra ky përkeqësim i rezultatit Z, nga viti 2009 e radhitën firmën në rangun e firmave që kanë rrezik nga bankroti, ndër firmat me performanca të dobëta financiare, pra krijon një imazh negativ për kompaninë dhe dëshmon për uljen e likuiditetit dhe paqëndrueshmërisë financiare.

Këto rezultate që kanë pasur një trend rënës të vazhdueshëm, të cilat në vitin 2009 dhe 2010 ka arritur në më pak se 1.8, që tregon një performancë të ulët financiare dhe me rrezik të lartë, kanë ndikuar që në vitin 2011 të hapet procedura e procesit të falimentimit nga ana e vet debitorit, nga pamundësia e për të vazhduar realizimin e aktivitetit të saj.

Me përpilimin e një plani të riorganizimit me standarde ndërkombëtare u vendos që firma në afat 5 vjeçar të arrijë ti mbulojë obligimet ndaj debitorëve të garantuar në vlerë 100 % të obligimeve, ndërsa debitorëve tjerë dhe punëtorëve tua shlyej obligimet në vlerë prej 60 % nga vlera e kërkesës së paraqitur në hapjen e procedurës së falimentimit.

Përlogaritja e Altman Z-score per periudhën 2005 - 2009 të Shik Jelak, prezantohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr.11

Vitet	1.2	X1	1.4	X2	3.3	X3	0.6	X4	1	X5	Z-rezultati
2005	1.2	0.3783	1.4	0.0011	3.3	0	0.6	0.9105	1	0.0157	1.0175
2006	1.2	0.3952	1.4	0.0010	3.3	0	0.6	0.8567	1	0.1058	1.0954
2007	1.2	0.3447	1.4	0.0010	3.3	0	0.6	0.8998	1	0.0480	1.0031
2008	1.2	0.2710	1.4	0.0011	3.3	0	0.6	0.9142	1	0.0179	0.8932

Rezultatet e përfituara nga ky model tregojnë se kompania ka pasur ulje të vazhdueshme të rezultatit Z, edhe atë nga viti 2007 dhe 2008 me Z-rezultat 1.01 gjegjësisht 1.09, ky një rezultat me koeficient më të vogël 1.8 që tregon performancë të ulët financiare, që informon se kompania është në zonën e rrezikut.

Ulja e koeficientit të Z vazhdon edhe në vitin 2007 dhe 2008, edhe atë në 1.0 gjegjësisht në vitin 2007, kurse në vitin 2008 Z-rezultati arrijnë vlerën më të ulët me 0.89, pra ky përkeqësim i rezultatit Z, nga viti në vit edhe atë me ulje drastike, nën 1.8 e radhitën firmën në rangun e firmave që kanë rrezik të lartë bankroti.

Kapitali i punës në raport me aktivën totale - X1 në vitin 2005 ka qenë 0.3783, ku deri në fund të vitit 2006 arrijnë në 0.3952. Kështu në vitin 2007 kemi ulje të kapitalit punës në raport të aktivës totale - X1 nga viti paraprak edhe atë arrijnë në 0.3447, e cila ka tendencë të zvogëlimit edhe në vitin 2008 arrijnë 0.2710, që do të thotë se detyrimet afat shkurte janë më të mëdha se aktivet afat shkurte.

Sa i përket fitimit të akumuluar në raport me aktivën totale - X2 gjithashtu, shihet qartë se ndërmarrja gjithmonë ka akumuluar humbje edhe atë nga viti 2005 asetet janë financuar nga borxhet e kompanisë, kështu që fitimi i akumuluar në raport me aktivën totale nga viti 2005 arrijnë koeficientin 0.0011, kjo performancë nuk ka përmisime deri në vitin 2008.

Rezultatet e X3 - fitimit para tatimit dhe taksave në raport me aktivën totale tregojnë se ndërmarrja në vitin 2005 deri në vitin 2008 ka akumuluar humbje, prandaj edhe X3 ka qenë 0.

Sa i përket raportit të kapitalit ndaj detyrimeve totale - X4, mund të vërejmë se ndërmarrja nga viti 2005 deri në vitin 2008 detyrimet janë të paguara në afate të rregullta kohore, edhe atë nga viti 2005 raporti kapitalit ndaj detyrimeve arrijnë koeficientin 0.9105 i cili është përafërsisht i njëjtë deri në vitin 2008, që do të thotë që ndërmarrja ka kapital të lartë punues dhe kjo ndikon që detyrimet e saja të mbulohen nga ky kapital. Sa i përket shitjes neto në raport me aktiven totale - X5, shihet qartë se ndërmarrja nga viti 2005 deri në vitin 2006 ka pasur rritje të kërkesave edhe pse shitjet kanë qenë shumë të ulëta, ndërsa nga viti 2007, fillon të ketë rënie të kërkesave, kështu që në vitin 2008 arrin koeficientin 0.0179.

Nga e gjithë kjo fitojmë Z - rezultatin të performancave financiare të Modelit për bankrot të Altmanit. Nga tabela më lartë shihet qartë se nga viti 2005 Z - rezultati ka arrijë koeficientin 1.0175, që është koeficient më i vogël se 1.81, ku sipas Modelit të Altmanit ndërmarrja në fjalë që nga viti 2005 ka ekzistuar mundësia e dështimit brenda vitit.


Këto rezultate vazhdojnë nga viti në vit dhe ku në vitin 2008 situata edhe me shumë i përkeqësohet ndërmarrjes, ku Z - rezultati arrijnë koeficientin 0.8932, pra ky përkeqësim i vazhdueshëm i rezultatit Z, e radhitën firmën në rangun e firmave që kanë rrezik nga bankroti, ndër firmat me performanca shumë të ulëta financiare, pra krijon një imazh negativ për kompaninë dhe dëshmon për uljen e likuiditetit dhe paqëndrueshmërisë financiare.

Këto rezultate që kanë pasur një trend gjithmonë rënës e jo likuid në më pak se 1.8, që tregon performanca të ulëta financiare dhe rrezik të lartë, që shihet qarte se ndërmarrja në fjalë nga viti 2005 e deri në vitin 2008 gjithmonë ka pasur zvogëlime të kapitalit dhe rezervave të saja, si dhe pjesën më të madhe të aktivitetit të saj e financon nga detyrimet afatgjate dhe afatshkurta, kjo e detyron që në vitin 2009 të hapet procedura e procesit të falimentimit nga ana e kreditorëve të saj dhe kjo ka ndikuar në pamundësinë për të vazhduar realizimin e aktiviteteve të saja.

Nëse do të krahasonim të rezultatet e përfituara nga zbatimi i modelit të Altmanit, tek të dy kompanitë e analizuara mund të vërejmë se kompania e Shik Jelak ka pasur Z rezultate më të ulëta se 1.81 që nga fillimi i viteve të analizuara, kjo tregon edhe strukturë joadekuate të pozicioneve në Bilancin e Gjendjes, e cila ka ndikuar që tek ky rast mos të merren masa për hapjen e procedurës së riorganizimit, për arsye se gradualisht ka gjeneruar humbje gjatë procesit të prodhimit si dhe shihet qartë se viteve të fundit edhe kërkesat janë shumë të zvogëluara.

Në rastin e Teteks Yarn Z - rezultati ka qenë i ndryshëm, ku vitet e para nuk kemi pasur anomali dhe mundësi të dështimit në ndërmarrje sepse Z - rezultati ka qenë më i madh se 2.67, ndërsa viteve të fundit u zvogëlu në 1.4581 dhe gjithashtu në këtë kohë arrijnë deri në hapjen e procedurës së falimentimit, mirëpo kërkesat e mëdha të produkteve, reparti makinerik pozitiv dhe funksional dhe garancionet nga debitorët ndikuan që në këtë ndërmarrje të hapet procedura e riorganizimit.

**Krahasimi i rezultateve të përfituara nga modeli i Altman për të dy ndërrmarjet
Altman Z-score e “ Teteks Yarn “**



Burimi : Përlllogaritje nga vet autori


Nga ky grafikon shihet qartë se:

- x_{1i} - kapitali punues në raport të aktivës totale, është një tregues i mirë i aftësisë së njësive ekonomike për të kompensuar borxhet e saja në muajt e ardhshëm, në Teteks Yarn në vitin 2007 ka qenë në 0.2935 dhe me trend rritës deri në vitin 2009 edhe atë deri në 0.3026, ndërsa nga 2010 kemi ulje drastike të kapitalit punues në raport të aktivës totale - X1, që arrijnë nën 0.0636, që nënkupton se detyrimet afat shkurte janë shumë më të mëdha se aktivet totale.
- Sa i përket x_{2i} - fitimi i akumuluar në raport me Aktivën totale, është tregues që tregon se sa në borxh është njësia ekonomike dhe nëse ajo ka një histori të përfitimit, ku në rastin tonë kemi ulje drastike të këtij treguesi nga viti në vit edhe atë nga viti 2007 deri në vitin 2010 asetet kanë pësuar rënie të vazhdueshme nga 0.0857 në vitin 2007 deri në 0.0298 në vitin 2010, që deri në vitin 2009 shumica e aseteve janë financuar nga fitimi i akumuluar ndërsa në vitin 2010 asetet nuk kanë pasur mundësi financimi nga fitimi pasi që humbja është rritur dhe asetet janë financuar nga borxhet e kompanisë.
- Sa i përket x_{3i} - Fitimi para tatimit dhe taksave në raport me aktivën totale shihet qartë se ndërmarrja në vitin 2007 ka një fuqi shumë të lartë të akumulimit të fitimit në kompani edhe atë 0.1151, me tendencë të rënies nga viti në vite ku qe shihet se deri në vitin 2009 kompania ka qenë jo shumë likuide mirëpo me bonitet pozitiv, ndërsa me 2010 koeficienti i fuqisë së akumulimit të fitimit në kompani bie deri më -0.0586 që don të thotë paraqet humbje e madhe në vitin 2010 në krahasim me vitet paraprake.

- Sa i përket x_{4i} - Raporti i kapitalit ndaj totalit të detyrimeve ku mund të themi se është një tregues variabël i besueshmërisë së tregut në njësinë ekonomike, ku sipas rezultateve të përfituara shihet qartë që ndërmarrja nga viti 2007 deri në vitin 2010 detyrimet e saja janë të paguara në afate kohore të rregullta, prandaj edhe koeficientët nga ky raport janë pozitiv.

- Sa i përket x_{5i} - shitjet neto në raport me Aktivën totale, vërejmë që ndërmarrja nga viti 2007 në vitin 2008 ka pasur rritje drastike shumë pozitive ku nga viti 2007 me koeficient 0.7794 në vitin 2008 arrijnë në 1.7358 që është një rritje pozitive për ndërmarrjen, ndërsa nga viti 2009 X5 fillon të bie dhe arrijnë në 0.3209 që ka qenë edhe viti me më pak shitje dhe proces pozitiv, kështu që në vitin 2010 arrijnë koeficientin pozitiv edhe atë 0.9362 që është më i lartë se në vitin 2007, që nënkupton edhe në momentin e zvogëlimit të likuiditetit shitja ka qenë e mjaftueshme, mirëpo rritja joefikase e shpenzimeve në vitin 2010 do të ndikon në uljen e likuiditetit dhe insolventitetit të ndërmarrjes.

Altman Z-score e “ Shik Jellak “



Burimi : Përlllogaritje nga vet autori

Nga ky grafikon shihet qartë se:

- x_{1i} - Kapitali punues në raport të aktivës totale në vitin 2005 ka qenë me performanca pozitive 0.3783 dhe deri në fund të vitit 2006 ku performancat ishin 0.3952, kështu në vitin 2007 kemi ulje të kapitalit të punës në raport të aktiveve totale nga viti paraprak edhe atë që arrijnë në 0.3447, me tendencë të zvogëlimit edhe në vitin 2008 ku arrijnë 0.2710, që do të thotë se detyrimet afatshkurte janë më të mëdha se aktivet afat shkurte.

- Sa i përket x_{2i} - fitimi i akumuluar në raport me Aktivën totale gjithashtu, shihet qartë se ndërmarrja gjithmonë ka akumuluar humbje edhe atë nga viti 2005 asetet janë financuar nga borxhet e kompanisë, kështu që nga viti 2005 deri në vitin 2008 performancat nuk kanë ndryshuar nga intervali 0.0011-0.0010.

- Sa i përket x_{3i} - Fitimi para tatimit dhe taksave në raport me aktivën totale mund të vërejmë që ndërmarrja nga viti 2005-2008 ka gjeneruar humbje.

- Sa i përket x_{4i} - Raporti i kapitalit ndaj totalit të detyrimeve, rezultatet tregojnë që ndërmarrja nga viti 2005 deri në vitin 2008 detyrimet e saja i ka paguar në afate kohore të rregullta, edhe atë nga viti 2005 me koeficient 0.9105 deri në vitin 2008 ku koeficienti ka qenë i përafërt dhe me ndryshime të vogla nga viti në vit, kështu që në vitin 2008 arrijnë në 0.9142, që do të thotë gjatë procesit të falimentimit ndërmarrja posedon kapital me anë të cilave mund të bëhet shlyerja e obligimeve të saja.

- Sa i përket x_{5i} - shitjet neto në raport me Aktivën totale, vërejmë që ndërmarrja në vitin 2005 ka pasur koeficient të ulët në shitje, ki koeficient rritet në vitin 2006 në vlerë 0.1058, ndërsa nga viti 2007 deri në vitin 2008 shitja neto në raport me aktivën përgjysmohet, kështu që në vitin 2008 arrijnë koeficientin 0.0179, që do të thotë që kërkesat në procesin e prodhimit janë shumë të ulëta.

Nëse do të krahasonim të rezultatet e përfituara nga zbatimi i modelit të Altmanit, tek të dy kompanitë e analizuara mund të vërejmë që variablat e Kapitalit punues në raport të aktivës totale - x1 dhe raporti i kapitalit ndaj totalit të detyrimeve - X4 parametrat kanë qenë të përafërta tek të dy ndërmarrjet, ndërsa tek variablat X2 dhe X3 kemi dallime të mëdha sepse tek ndërmarrja Teteks Yarn kemi fitime në vitet e para të mara në analizë dhe pastaj në vitet e fundit paraqitet humbja, ndërsa tek ndërmarrja Shik Jellak gjithmonë ka akumuluar humbje.

Nga varibla X5 mund të shihet qartë që në Teteks Yarn gjithmonë kemi kërkesa për produkteve prandaj edhe shitja neto është në nivel shumë më të latë se sa në ndërmarrjen Shik Jellak.

Vlen të theksohet fakti që variabla X4 tek Shik Jellak është më e madhe për shkak se kapitali i lartë ndërmarrjes i mbulon detyrimet që akumulohen gjatë procesit të prodhimit.

4.5.2 Rezultatet e përfituara nga zbatimi i modelit për bankrot Konan Holder

Modeli i dytë më i njohur për bankrot është zhvilluar nga autorët Konan dhe Holder, ku dhe në bazë të tyre është pagëzuar si modeli Konan-Holder (Conan-Holder method). Ky model është zhvilluar në vitin 1978, ku si objekt analize ka pasur 190 kompani të mesme.

Modeli përbëhet nga pesë variabla nga të cilat kanë krijuar këtë ekuacion matematikor:

$$z_i = 0.24x_{1i} + 0.22x_{2i} + 0.16x_{3i} + 0.87x_{4i} + 0.1x_{5i} \quad \text{ku,}$$

x_{1i} - Bruto të hyrat / bruto obligimet

x_{2i} - Kapitali i evidentuar / Totali i aktivës

x_{3i} - Aktivitet vijuese - Stokset / Obligimet vijuese

x_{4i} - Të dalat e financimit / Të hyrat bruto

x_{5i} - Shpenzimet e bruto pagave / Të hyrat bruto

Ndërmarrja konsiderohet në zonën e rrezikut varësisht nga vlera e rezultatit, edhe atë :

Gjendja e kompanisë	Vlera e rezultatit	Rreziku i bankrotit
E lartë	$Z > 0.16$	Deri 10%
E mirë	$0.10 < Z < 0.16$	10% - 30%
E pa sigurt	$0.04 < Z < 0.10$	30% - 65%
Jo e favorshme	$-0.05 < Z < 0.1$	65% - 90%
Katastrofike	$Z < - 0.05$	Mbi 90%

Modeli i Konan dhe Holder zakonisht gjeneron rezultate të rëndësishme në parashikimin afatshkurtër të zhvillimit të kompanive tregtare. Ky lloj i modelit është i saktë vetëm kur vepron rregullorja e falimentimit, kur anulohen subvencionet e fshehura dhe statistikat janë adekuate.

Duke u bazuar tek ky model dhe duke marrë parasysh të dhënat financiare të Teteks Yarn, është bërë përlllogaritja e këtyre vlerave duke filluar nga viti 2007 deri në vitin 2010.

Tabela Nr.12

Vitet	0.24	X1	0.22	X2	0.16	X3	0.87	X4	0.1	X5	Z Rez.
2007	0.24	2.0409	0.22	0.5160	0.16	1.0973	0.87	0.8522	0.1	0.1599	1.5363
2008	0.24	3.4269	0.22	0.4038	0.16	1.1416	0.87	0.9766	0.1	0.1444	1.9580
2009	0.24	1.8958	0.22	0.3224	0.16	1.0968	0.87	1.0266	0.1	0.1877	1.6134
2010	0.24	1.0712	0.22	0.1823	0.16	0.6550	0.87	1.1141	0.1	0.1355	1.3849

Nga të dhënat e paraqitura në bazë të modelit Konan Holder mund të konstatojmë se rreziqet e kompanisë për bankrot janë më të ulëta se 10%, pasi në të gjitha vitet vlera e Z është më e lartë se 0,16 pra $Z > 16$. Nga Z - rezultati i bankrotit shihet qartë se nga viti 2007 arrijnë koeficientin 1.5363 që do të thotë se ekziston mundësia që ndërmarrja të dështoj brenda viteve të ardhshme, por ky rezultat në vitin 2008 rritet në 1.9580 që është më i madh se 1.8 dhe se mundësia për bankroti anuluar.

Në vitin 2009 gjithashtu ndërmarrja hyn në zonën e rrezikut, e cila gradualisht ndikon në mbulimin e fitimit të akumuluar nga vitet e kaluara dhe gjenerim të humbjes, ku shihet se Z rezultati në vitin 2010 arrijnë koeficientin 1.3849, pasi këtu kemi edhe zvogëlim të të hyrave, zvogëlim të kapitalit punues, zvogëlim te stoqeve dhe rritje të shpenzimeve dhe të obligimeve.

Pra nëse shikojmë trendin nga viti në vit ai gjithmonë bëhet me i ulët, kjo shenjë që tregon se organizata po hyn në fazat e para të falimentimit dhe është i nevojshëm ndryshimi i zhvillimit të aktiviteteve të ndërmarrjes dhe marrja e vendimeve pro aktive në mënyrë që të anashkalohen anomalitë e paraqitura, të gjithë këto anomali gjatë procesit të prodhimit mundeshin të anashkalohen vetëm nëpër mjet procesit të falimentimit duke përpiluar plan të mirëfilltë të riorganizimit.

Gjithashtu Modeli i Konan Holder është zbatuar edhe tek të dhënat financiare përfundimtare nga viti 2005 deri 2008 të paraqitura në Regjistrin Qendror të R.M nga ana e kompanisë së Shik Jelak.

Nga përlogaritja e këtyre koeficienteve nga vitet e dhëna, paraqitet tabela në vazhdim :

Tabela Nr.13

Vitet	0.24	X1	0.22	X2	0.16	X3	0.87	X4	0.1	X5	Rez.
2005	0.24	0.0599	0.22	0.9292	0.16	2.2498	0.87	4.7751	0.1	0.9838	4.8316
2006	0.24	0.3198	0.22	0.8744	0.16	2.0658	0.87	0.9218	0.1	0.1614	1.4177
2007	0.24	0.1247	0.22	0.9183	0.16	1.7791	0.87	0.7785	0.1	1.1424	1.3081
2008	0.24	0.0375	0.22	0.9254	0.16	1.4635	0.87	1.4413	0.1	2.5817	1.9589

Gjithashtu edhe tek kompania e Shik Jelak nga të dhënat e përfituara nga përlllogaritja e koeficientëve të modelit të Konan Holder mund konstatojmë se rreziqet e kompanisë për bankrot janë më të ulëta se 10%, pasi në të gjitha vitet vlera e Z është më e lartë se 0,16 pra $Z > 16$. Mirëpo performancat financiare të kësaj ndërmarrje rezultojnë në atë se Z rezultati i kësaj ndërmarrje nga viti 2005 ka qenë 4.8316, pra ky rezultat është shumë pozitiv, ku në këtë rezultat të lartë ka ndikuar ajo që kjo ndërmarrje posedon kapital shumë të lartë dhe parku makinerik i saj është shumë i gjerë.


Edhe pse në vitin 2005 ka gjeneruar humbje përsëri koeficientët dalin pozitive, në vitin 2006 Z - rezultati zvogëlohet në 1.4177, që tregon se trefishohen të dalat dhe obligimet si dhe zvogëlohen të hyrat dhe kërkesat e blerësve për produkte dhe shërbime.

Nëse analizojmë trendin nga viti në vit ai gjithmonë bëhet më i ulët, kjo shenjë që tregon se organizata po hyn në fazat e para të falimentimit. Duhet pasur parasysh edhe anomali të këtij modeli do të ishte e nevojshme marrja e vendimeve të shpejta për të mos ecur me shpejtësi të madhe drejt hapjes së procedurës së falimentimit.

Shenjat e para të falimentimit u paraqitën që nga viti 2007 ku firma ballafaqohej me bllokime të ndryshme financiare si dhe me mos menaxhim të mirëfilltë nga ana e udhëheqësve të saj.

Krahasimi I rezultateve të fituara nga modeli për bankrot i Konan Holder të dy firmave.

Modeli për bankrot i Konan Holder “ Teteks Yarn “



Burimi : Përlllogaritje nga vet autori

Nga ky grafikon shihet qartë se:

x_{1i} - Bruto të hyrat në krahasim me bruto obligimet nga viti 2007 shihet qarte se të hyrat bruto kanë qenë shume më të larta se obligimet edhe atë në vitin 2007 arrijnë koeficientin 2.0409, ku në vitin 2008 arrijnë koeficientin 3.4269, por ky trend nga viti 2009 fillon të zvogëlohet, ku me rritjen e obligimeve arrijnë në 1.8958, ndërsa në vitin 2010 obligimet rriten edhe më shumë, ku shihet se koeficienti bie në 1.0712.


x_{2i} - Kapitali i evidentuar në raport me totalin e aktivës shihet se nga viti në vite pëson ulje, edhe atë nga viti 2007 që është 0.5160 në 2010 arrijnë deri 0.1823.

x_{3i} - Aktivitet vijuese duke i zvogëluar me stoqet e mallrave në proporcion me obligimet vijuese nga viti në vit kemi ulje, edhe atë nga viti 2007 shihet se stoqet kanë qenë më të mëdha dhe me trend të zvogëlimit deri në vitin 2010, kështu që nga analiza financiare shihet qartë se X3 nga 1.0973 me trend të zvogëlimit, si pasojë e zvogëlimit të stoqeve dhe rritjes së obligimeve gradualisht bie dhe në vitin 2010 arrijnë koeficientin 0.6550 apo dyfish më të vogël se në vitin 2007.

x_{4i} - Të dalat e financimit në proporcion me të hyrat bruto nga viti 2007 mund të vërrejmë se ndërmarrja ka pasur bilanc pozitiv dhe se ke gjeneruar fitim, i cili nga viti në vit është zvogëluar. Në 2007 kemi pasur fitim të lartë për shkak se shpenzimet kanë qenë më të vogla se sa të hyrat e përgjithshme dhe arrijnë koeficientin $X4=0.8522$, gjë që në vitin 2010 ka pasur ndryshime në raportet financiare dhe shihet qartë neglizhenca e stafit koordinues dhe që në vitin 2010 gjeneron humbje dhe X4 arrijnë në 1.1141.

x_{5i} - Shpenzimet e bruto pagave në raport me të hyrat bruto që nga viti 2007 deri në vitin 2009 është me trend rritës, si pasojë e rritjes së shpenzimeve në raport me të hyrat bruto, ku shihet edhe në analizat tjera financiare që nga viti 2007 ku kemi fitim, i cili nga viti në vit po zvogëlohet si pasojë e rritjes së shpenzimeve joefikase dhe në vitin 2010 na paraqitet humbje e madhe si pasojë e mos llogaritjes së normativeve fikse gjatë procesit të prodhimit, ku në bazë të analizave financiare për prodhimin apo ngjyrosjen e fijeve të mëndafshhta ka harxhuar dyfish në krahasim me çmimin shitës, shkak që ndikojë në hapjen e procedurës së falimentimit në vitin 2011, ku edhe variabla X5 në 2010 arrijnë 0.1355.

Modeli për bankrot i Konan Holder “ Shik Jelak “



Burimi : Përlllogaritje nga vet autori

Nga ky grafikon shihet qartë se:

x_{1i} - Bruto të hyrat në krahasim me bruto obligimet nga viti 2005 tregojnë se të hyrat buto kanë qenë shumë më të vogla se sa obligimet edhe atë në vitin 2005 arrijnë koeficientin 0.0599, ku në vitin 2006 ky ndryshim shumë pak po përmisohet, mirëpo nga viti 2007 deri në vitin 2008 të hyrat gradualisht akoma më shumë po zvogëlohen dhe që arrijnë koeficientin 0.0375 akoma me të ulët se në vitin 2005.

x_{2i} - Kapitali i evidentuar në raport me totalin e aktivës që nga viti 2005 mban rënie konstante të njëjtë nga viti në vit, dhe nga kjo mund të konstatojmë që ndërmarrja që nga fillimi dhe deri në vitin 2008 nuk ka pasur zvogëlim të kapitalit themelor, kështu që X2 nga viti 2005 ka qenë 0.9292 me një trend të vogël të ndryshimit në vitin 2008 arrijnë në 0.9254

x_{3i} - Aktivitet vijuese duke i zvogëluar me stoqet e mallrave në proporcion me obligimet vijuese që nga viti në vit kemi ulje, edhe atë nga viti 2005 stoqet kanë qenë më të mëdha dhe me trend të zvogëlimit deri në vitin 2008, kështu që nga analiza financiare shihet qartë se X3 nga 2.2498 me trend të zvogëlimit, si pasojë e zvogëlimit të stoqeve dhe rritjes së obligimeve gradualisht zvogëlohen dhe në vitin 2008 arrijnë koeficientin 1.4635 apo dyfish më të vogël se në vitin 2005.

x_{4i} - Të dalat e financimit në proporcion me të hyrat bruto nga viti 2005 shihet se në vitin 2005 kemi pasur humbje të madhe për shkak se shpenzimet kanë qenë të përafërta nga viti në vit me një trend të zvogëlimit, mirëpo të hyrat gjithashtu kanë qenë shumë të vogla në krahasim me të dalat. Nga grafikoni vërejmë se në vitin 2005 X4 ka qenë 4.7751, ndërsa në vitin e ardhshëm kemi zvogëlim drastik të shpenzimeve si dhe rritje të hyrave, gjë që nuk vazhdon në vitet e ardhshme, ku të hyrat filluan dyfish të zvogëlohen, ndërsa shpenzimet gati të barabarta me vitet paraprake, kështu që në vitin 2008 koeficienti i X4 arrijnë në 1.4413.

x_{5t} - Shpenzimet e bruto pagave në raport me të hyrat bruto që nga viti 2005 deri në vitin 2008 është me trend rënës, si pasojë e zvogëlimit i të hyrave bruto në raport me të dalat bruto, ku shihet edhe në analizat tjera financiare që nga viti 2005 firma në fjalë ka punuar me humbje, edhe atë koeficienti i X5 nga viti 2005 arrijnë 0.9838, si pasojë e rritje së të dalave kjo variabël në vitin 2008 arrijnë në 2.5817.

Nëse do të krahasonim të rezultatet e përfituara nga zbatimi i modelit të Konan Holder, tek të dy kompanitë e analizuar mund të vërejmë tek variabla $X1 = \text{Bruto te hyrat në raport me obligimet}$ janë shumë të ndryshme si pasojë se ndërmarrja Teteks Yarn në 3 vitet e para ka gjeneruar fitime me trend rënës, ndërsa Shik Jellak gjithmonë ka pasur humbje dhe rritje të obligimeve.

Ndërsa sa i përket kapitalit të evidentuar në raport me totalin e aktivës shihet qartë se Teteks Yarn disponon kapital më të vogël se Shik Jellak mirëpo me kërkesa shumë të mëdha në krahasim me Shik Jellak, nga e gjithë kjo vërejmë se Shik Jellak në mënyrë të fshehtë duke i rritur shpenzimet dhe obligimet ka ndikuar në harxhimin total të kapitalit themelore.

Aktivitet vijuese duke i zvogëluar me stoqet e mallrave në proporcion me obligimet vijuese, tek të dy ndërmarrjet kemi rënie nga viti në vit, që do të thotë se tek të dy ndërmarrjet ka pasur zvogëlim të mjeteve kapitale si dhe zvogëlimin të stoqeve, ndërsa rritje të obligimeve.

Të dalat e financimit në proporcion me të hyrat bruto, tek Teteks Yarni kemi rritje graduale nga viti në vit, ndërsa tek Shik Jellak ndodhë e kundërta, ku në fillim ka pasur dallim të vogël në mes të dalave dhe të hyrave dhe pastaj gjithmonë të dalat kanë qenë shumë më të mëdha se të hyrat.

Shpenzimet e bruto pagave në raport me të hyrat bruto në Teteks Yarn kanë qenë konstante për shkak numrit konstant i të punësuarve, ndërsa tek Shik Jellak kemi ndryshime drastike ku shihet qartë që ka pasur më tepër fuqi punëtore se sa ka qenë e nevojshme në krahasim me mallrat e prodhuara.

4.5.3 Rezultatet e përfituara nga zbatimi i modelit për bankrot Tafler (Taffler)

Modeli i tretë të cilin do të analizojmë për të përcaktuar rrezikun e falimentimit të kompanive në fjalë është modeli i Tafler. Ky model për herë të parë u përdor në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1977 nga ana e Taffler dhe Tishaw, të cilët u bazuan në një mostër prej 92 kompanive prodhuese.

Ekuacioni i këtij modeli ka këtë strukturë :

$$z_i = 0.53x_{1i} + 0.13x_{2i} + 0.18x_{3i} + 0.16x_{4i} \quad \text{ku,}$$

x_{1i} - Bruto të hyrat / Detyrimet vijuese (53%)

x_{2i} - Aktivitet vijuese / Totali detyrimeve (13%)

x_{3i} - Detyrimet vijuese / Totali aktiveve (18%)

x_{4i} - Të hyrat nga shitja / Totali i aktiveve (16%)

Përqindjet paraqesin një udhëzues për peshën relative të raporteve. Taffler dhe Tishaw arritën një klasifikim të suksesshëm ku u bazuan në 92 kompani, prej të cilave edhe u nxor modeli. Megjithatë, ky model u testua nga Taffler (1983), nga një mostër prej 825 kompanive, rezultatet ishin më pak bindëse. Në këtë testim u klasifikuan 115 kompani nga 825 si të rrezikuara nga falimentimit, kurse në katër vitet e ardhshme 35% falimentuan dhe 27% të tjera ishin ende në rrezik.

Kufijtë e vlerësimit të rrezikut të bankrotit sipas këtij modeli janë :

Z Rezultati	Indikacionet
$Z \leq 0.2$	Mundësi e lartë bankroti
$Z \geq 0.3$	Zona e përhimt

Duke u bazuar në të dhënat sekondare të Teteks Yarn është bërë përlllogaritja e këtij modeli nga viti 2007 deri 2010.

Tabela Nr.14

Vitet	0.53	X1	0.13	X2	0.18	X3	0.16	X4	Z rezultati
2007	0.53	0.3016	0.13	1.7687	0.18	0.3818	0.16	0.7779	0.5830
2008	0.53	0.1116	0.13	1.4656	0.18	0.3629	0.16	1.7273	0.5914
2009	0.53	0.0035	0.13	1.3023	0.18	0.5069	0.16	1.1680	0.4493
2010	0.53	-0.0739	0.13	0.9774	0.18	0.7929	0.16	0.8301	0.3634

Nga të dhënat e paraqitura në bazë të modelit Tafler mund të konstatojmë se rreziqet e kompanisë për bankrot në vitin 2007 dhe 2008 aspak nuk kanë ekzistuar për shkak se ndërmarrja në fjalë ka qenë likuide ku dhe Rezultati Z ka qenë 0,5930 apo dyfish më i lartë se norma e rrezikut apo e falimentimit, kjo shfaqet si pasojë e kërkesave të larta dhe mjeteve materiale dhe jo materiale të cilat i posedon ndërmarrja, kështu që aktiva e ndërmarrjes në vitin 2009 ka një ulje të vogël ku shihet qartë se ndërmarrja ka ngecur në pagesën e obligimeve të cilat në vitin 2009 janë rritur, kjo rritje e obligimeve ndikoi negativisht në vitin 2010 ku dhe rezultati Z arriti normën 0.3634, ku ekziston mundësia për falimentim të ndërmarrjes.

Këto anomali të shfaqura ndikuan që në vitin 2011 të hapet procedura e falimentimit, mirëpo për shkak të kushteve elementare që posedonte për riorganizimin e ndërmarrjes si dhe rezultati Z në shkallën minimale të falimentimit ndikuan që kjo ndërmarrje të rimëkëmbet nga plani i organizimit. Duke vërejtur Rezultatin Z, mund të konstatojmë se në këtë ndërmarrje nga viti 2007-2009 nuk kemi pasur elemente falimentuese, ndërsa në vitin 2010 ka pasur Z rezultat të ulët që e radhitën ndërmarrjen në zonën e përhimt apo mundësinë e ulët për falimentim, gjë që rezultoi dhe u shfaq në vitin 2011.

Përlogaritja e modelit të Tafler nga të dhënat e financiare të Shik Jelak paraqitet në këtë tabelë :

Tabela Nr.15

Vitet	0.53	X1	0.13	X2	0.18	X3	0.16	X4	Z rezultati
2005	0.53	-0.3365	0.13	2.4417	0.18	0.2624	0.16	0.0157	0.1889
2006	0.53	-0.0707	0.13	2.1953	0.18	0.3306	0.16	0.1057	0.3244
2007	0.53	-0.2248	0.13	1.8960	0.18	0.3847	0.16	0.0480	0.2043
2008	0.53	-0.1948	0.13	1.5666	0.18	0.4783	0.16	0.0179	0.1894

Nga të dhënat e paraqitura në bazë të modelit Tafler, nga tabela shihet qartë se nga viti 2005 Z Rezultati është në kufijtë të bankrotit apo falimentimit, kjo ka ndodhur për shkak se të hyrat kanë qenë shumë të vogla në krahasim me detyrimet dhe ka arritur normën 0.1889 që përcakton mundësi të lartë të bankrotit, e cila si pasojë e falimentimit të ndërmarrjes, organet menaxhuese të ndërmarrjes ndikuan në rritjen e të hyrave si dhe në zvogëlimin e detyrimeve të saja.

Kështu që në vitin vijues të aktivitetit prodhues, pra në vitin 2007, ndërmarrja në fjalë e zvogëloi normën e përcaktimit të falimentimit, apo Z Rezultati u rrit për 42 % apo në koeficient 0.3244 që ishte një mundësi pozitive e shlyerjes së obligimeve në kohë të caktuar, e që nuk vazhdoi shumë gjatë, i njëjti staf udhëheqës nuk arriti që në periudhë të gjatë të udhëheq në bazë të Kodeksit të etikës, kështu që përsëri në vitin 2007 të hyrat nuk arritën ti mbulojnë detyrimet të cilat vazhdimisht rriteshin dhe që në vitin 2007 Z Rezultati, bie deri në 0.2043 që paraqet mundësi të lartë bankrotit, e cila nuk ndodhi këtë vit si pasojë e shitjes së prodhimeve të gatshme që i dispononte ndërmarrja.

Nga viti 2007 deri në vitin 2008 kemi ulje të koeficientit tregues për falimentim për 58 %, që është si pasojë e uljes së përgjysmuar i të hyrave. Viti 2008 solli humbje më të mëdha dhe po rritej mundësia e falimentimit të ndërmarrjes, ku edhe sipas modelit të Tafflerit Rezultati Z arrijnë në 0.1894, që është $Z \leq 0.2$ tregon mundësi të lartë të falimentimit dhe që është i pashmangshëm.


Të hyra të zvogëluara maksimale, gjenerim i humbjes nga viti në vit dhe rritje e vazhdueshme e obligimeve, ndikuan që në vitin 2009 të bëhet hapja e procedurës së falimentimit.

Duke e bërë një krahasim të modelit të Tafflerit tek të dy ndërmarrjet mund të konstatojmë që në bazë të këtij modeli ndërmarrja Teteks Yarn nuk ka elemente të Falimentimit dhe rezultate që janë shumë të përafërta me planin e riorganizimit. Elemente kyç i kësaj ndërmarrje ishin të hyrat e garantuara nga blerësit e garantuar për lloje të ndryshme të prodhimeve të kësaj ndërmarrje dhe hapja e procedurës së falimentimit ndikoj në Riorganizimin e ndërmarrjes .

Sa i përket njësisë tjetër ekonomike Shik Jelak që nga viti 2005 mundësia e falimentimit ishte e lartë si pasojë e zvogëlimit drastik i të hyrave si dhe zvogëlimi i kërkesave së produkteve të prodhuara të kësaj kompanie.

Krahasimi i rezultateve të fituara nga modeli për bankrot Taffler i të dy firmave.

Modeli për bankrot Taffler (Taffler) “ Teteks Yarn “



Nga ky grafikon konstatojmë :

x_{1i} - Bruto të hyrat në krahasim me obligimet rrjedhëse në vitin 2007 kanë qenë pozitive dhe kanë arrit koeficientin 0.3016, e cila normë e të hyrave në krahasim me vitet e ardhëshme akumulon rritje të të hyrave, mirëpo njëkohësisht kemi edhe rritje të obligimeve rrjedhëse apo vijuese, prej vitit 2007 kemi ulje të koeficientit dhe që në vitin 2009 arrijnë afër 1.160 % më të ulët se në vitin 2007, apo nga 0.3016 që ishte në vitin 2007 arrijnë deri në 0.0035 në vitin 2009, ku shihet qartë se nga viti në vit të hyrat zvogëlohen, ndërsa obligimet gradualishtë po rriten.

Ky trend rritës mundësoi që në vitin 2010 hyrat në raport me obligimet vijuese të arrijnë në -0.0739 ku shihet qartë se të hyrat kanë qenë më të ulëta se obligimet dhe ndërmarrja në fjalë ka gjeneruar humbje si pasojë e rritjes së obligimeve të pa nevojshme në procesin e prodhimit, pra rritja e këtyre obligimeve nuk ka ndikuar në vazhdimin e procesit të prodhimit.


x_{2i} - Aktiva Vijuese në proporcion me detyrimet totale, vërrejmë se nga viti në vit ka ulje, edhe atë nga viti 2007 e deri në vitin 2010 kemi gati ulje te dyfishtë, ku shihet se detyrimet dyfisht janë rritur në krahasim me aktivën në fillim të procesit të prodhimit, shumë pak ndërmarrja ka investuar në parkun maqinerik të saj apo në ritjen e aktivës. Që nga viti 2007 me koeficient $X_2=1.7687$, ka vazhduar me trend rënës dhe në vitin 2010, X_2 arrijnë koeficientin 0.9774.

x_{3i} - Detyrimet vijuese në raport me aktivën totale, ketu kemi te kundërtën e X_2 , që nënkuptojmë nga viti 2007 X_3 e kemi në rritje, apo firma gjithmonë që nga viti 2007 i ka rritur obligimet në raport me aktivën, dhe që nga viti 2007 ku X_3 e kemi pasur me koeficient 0.3818, raporti i aktivës ka qenë më i vogël se obligimet, kjo është si rezultat e menaxhimit jo adekuat të vendimeve, pra shkaktuan rritjen e obligimeve apo borxheve duke mos investuar në rritjen e procesit së prodhimit. Deri në vitin 2010 X_3 arrijnë koeficientin gati dyfishtë më të lartë.

x_{4i} - Të hyrat nga shitja në krahasim me aktiven totale, nga viti 2007 shihet qartë se ndërmarrja ka pasur bilans pozitiv dhe se ke gjeneruar fitim, i cili nga viti 2007 deri në vitin 2008 ka rritje të dyfishtë, ku kemi edhe fitim të lartë në vitin 2008, si dhe bilans shumë pozitiv dhe koeficienti X4 nga 2007 me vlerë prej 0.7779 u rrit për afër 122 % më shumë dhe në vitin 2008 X4 arriti 1.7273.

Kjo rritje nuk vazhdoi në vitin e ardhshëm 2009, ku ky raport u zvogëlua për afër 32% dhe në vitin 2009 arriti X4=1.1680. Ky trend rënës vazhdoi me uljen e të hyrave në raport me aktivën vijuese dhe që X4 në vitin 2010 u zvogëlua edhe për afër 29% dhe ariti koeficientin 0.8301, ku shihet qartë se nga 2008 kemi zvogëlimin të vazhdueshëm të të hyrave.

Modeli për bankrot Tafler (Taffler) “ Shik Jelak “



Nga ky grafikon shihet qartë :

x_{1i} - Bruto të hyrat në raport me obligimet rrjedhëse në vitin 2005 kanë qenë negative apo -0.3365 me trend rritës dhe në vitin 2008 arrijnë n - 0.1948, nga kjo kuptojmë që ndërmarrja që nga fillimi ka gjeneruar humbje dhe vërejmë që nga viti 2007 deri në vitin 2008 gjithmonë kemi zmadhimin e detyrimeve në krahasim me të hyrat. Gjithashtu shihet qartë se në vitin 2006 është arritur pothuajse një përputhshmërisë së të hyrave në krahasim me detyrimet, mirëpo edhe në këtë vit kemi humbje në rezultatin financiar.

x_{2i} - Aktiva Vijuese në raport me detyrimet totale shihet se nga viti në vit ka ulje, edhe atë nga viti 2005 deri në vitin 2008 kemi pothuajse ulje të dyfishtë, ku shihet që detyrimet dyfish janë rritur në krahasim me aktivën në fillim të vitit 2005. Në vitin 2007, X2=2.4417 me trend rënës dhe në vitin 2008, X2 arrijnë 1.5666, kjo vjen si pasojë e aktivës pozitive në raport me detyrimet, sepse tek ndërmarrja Shik Jellak në aktiv dominon kapitali I patundshëm - prona, dhe pjesa tjetër përbëhet nga mjetet materiale apo parku makinerik si dhe kërkesat ndaj blerësve.

x_{3i} - Detyrimet vijuese në raport me aktivën totale, këtu kemi te kundërtën e X2 , që nënkuptojmë që nga viti 2005, X3 e kemi në rritje, apo subjekti ekonomik gjithmonë që nga viti 2007 i ka rritur obligimet në raport me aktivën. Nga viti 2007 ku X3 e kemi pasur me koeficient 0.2624 raporti i aktivës ka qenë më i vogël se obligimet, deri në vitin 2010 X3 arrijnë koeficientin gati dyfish më të lartë edhe atë $X3=0.4783$, ku bëhet fjalë për borxhe të mëdha të cilat e kalojnë kapitalin e ndërmarrjes.

x_{4i} - Të hyrat nga shitja në krahasim me aktivën totale, nga viti 2005 shihet qarte që ndërmarrja ka pasur bilanc negativ në procesin e prodhimit, me tendencë të zvogëlimit të humbjes në vitin 2006, mirëpo e cila nuk rezultoi në rritjen e të hyrave dhe të aktivës së ndërmarrjes, kështu që nga viti në vit kemi zvogëlimin e të hyrave si dhe rritjen e obligimeve, që nënkupton zvogëlimin e aktives.

Nga viti 2007 kemi zvogëlimin e të hyrave në raport me aktivën afër 55 % në krahasim me vitin 2006, ky trend rënës vazhdoi gjithashtu edhe në vitin 2008 ku koeficienti zvogëlohet deri më 0.0179, që është për afër 63 % më i vogël se në vitin 2007. Nga e gjithë kjo shihet qartë se në ndërmarrjen Shik Jellak kemi humbje gjatë viteve të fundit deri në hapjen e procesit të falimentimit.

4.6 Elementet kryesore të procedurës së falimentimit tek ndërmarrjet e huluntuara

Për riorganizimin e një ndërmarrje është shumë me rëndësi të merren parasyshë disa elemente reale dhe praktike, me të cilat ballafaqohet ndërmarrja, tek e cila përmes procesit të falimentimit me plan të riorganizimit do të ndikojë deri tek shlyerja e obligimeve:

- Është shumë me rëndësi të shihet se sa kohë është firma e bllokuar ?

Vlen të theksohet fakti se kohëzgjatja e ngeçjes financiare apo për sa kohë firma ka qenë e bllokuar ka një rëndësi të veçantë në rrjedhën e procesit të falimentimit nga e cila mund të konstatohet nëse firma do të ndërpres aktivitetin e saj apo do të hapë procedurë të riorganizimit. Në rastin tonë, Shik Jelak ka qenë për një periudhë të gjatë kohore e bllokuar pra rreth 10 vjet, gjë e cila ka ndikuar që ajo të hapë procedurë të falimentimit, kurse në Teteks Yarn periudha kohore e bllokimit të mjeteve financiare ka qenë e shkurtë, afërsisht rreth 4 muaj.

- Sa kohë është jo likuide ?

Jo likuiditeti është një indikator vendimtar në zhvillimin e aktivitetit të ndërmarrjeve dhe kur ai vihet në pikëpyetje atëherë cenohet jetëgjatësia e ndërmarrjes. Duke u bazuar në analizat financiare të dy ndërmarrjeve konstatoam që Shik Jelak ka hasur jo likuiditetin në një kohë më të gjatë rreth 20 vite, kurse në anën tjetër tek Teteks Yarn shenjat e para të likuiditetit janë paraqitur në fund të vitit 2010, që do të thotë rreth 6 muaj nga hapja e procedurës së falimentimit.

- Shumë me rëndësi është të dihet se a janë në funksion mjetet themelore (makineria)?

Mjetet themelore (parku makinerik) janë elemente kryesore të procesit të prodhimit dhe nëse ata janë në gjendje funksionale në momentet e hapjes së procesit të falimentimit atëherë do të ndikojnë në rrjedhën e këtij procesi. Në ndërmarrjen Shik Jelak mjetet themelore kanë qenë plotësisht të amortizuara dhe jofunksionale, kurse tek Teteks Yarn mjetet themelore kanë qenë funksionale dhe në gjendje të gatshme për të vazhduar procesin e prodhimit, të cilat i kanë ndihmuar që kjo ndërmarrje të hap procesin e falimentimit me plan të riorganizimit dhe të vazhdojë aktivitetin e saj.

- A janë të interesuar akoma blerësit (të lidhen kontratat me blerësit para kohe që ato të jenë të sigurt) ?

Kërkesat për blerjen e produkteve nga ana e blerësve kanë ndikim të rëndësishëm, sidomos kur ata janë të interesuara dhe të gatshëm që të lidhin kontrata dhe të bëjnë avance pagesore për prodhimin e produkteve kur firma është në krizë financiare, janë ata të cilat mund ta mbajnë gjallë një ndërmarrje.

Në rastet konkrete tek Shik Jelak asnjë blerës nuk ishte i gatshëm për avancim të parakohshëm të mjeteve financiare dhe njëkohësisht të kishte kërkesa për produktet e tyre, që është një faktor negativ dhe që nuk jep shans për vazhdimin e procesit të prodhimit, pra hapjen e procedurës së riorganizimit. Kurse në Teteks Yarn po ndodhte e kundërta, ku shumë blerës ishin të gatshëm të lidhnin kontrata dhe të vazhdonin kërkesat e tyre, me avancime të parakohshme, të cilat e ndihmonin procesin e prodhimit dhe një mundësi të dytë për ndërmarrjen që nëpërmjet procesit të falimentimit të riorganizohet.

- Kohëzgjatja e shlyerjes së obligimeve në bazë të planit të riorganizimit

Një ndër arsyet kryesore të hapjes së procedurës së falimentimit është mos aftësia e shlyerjes së obligimeve në afat të caktuar. Tek Shik Jelak nuk kemi plan të riorganizimit që nënkupton se obligimet ndaj furnitorëve janë të paguara proporcionalisht nga masa falimentuese.

Ndryshe nga Shik Jelak, në Teteks Yarn kemi plan të riorganizimit në bazë të cilit është bërë shlyerja e obligimeve. Në bazë të planit të riorganizimit, shlyerja e obligimeve bëhet në këtë mënyrë:

1. Shpenzimet e procedurës së falimentimit
2. Shlyerja e kërkesave të paraqitura në hapjen e procedurës së falimentimit.
3. Pagesa e kreditorëve ndaras – jashtë procedurës së falimentimit
4. Pagesa e kreditorëve me kërkesa të siguruara.
5. Pagesa e të gjitha shpenzimeve që do të paraqiten gjatë planit të riorganizimit.

4.7 Konkluzione dhe Rekomandime

Kompanit vazhdimisht kërkojnë alternativa që të mbeten konkurrenca në treg, megjithatë rreziku i dështimit në përmbushjen e kërkesave në rritje të aktivitetit ekonomik bashkëkohor është i pranueshëm dhe shumë më kërcënues se në periudhën paraprake. Dështimi i një kompanie ekonomike shfaqet në formën e falimentimit, mirëpo ekziston mundësia e riorganizimit gjatë procesit të falimentimit apo riorganizimit para hapjes së procedurës së falimentimit. Nëpërmjet aplikimit me sukses të modeleve të bankrotit të autoreve Altman Z, Konan-Holder dhe Taffler është dhënë një ide e qartë për pozitën financiare të dy kompanive të analizuara në këtë studim.

Rezultatet e vlerësimit të analizës financiare të llogaritur nëpërmjet modelit të Altmanit, të Konan - Holder dhe modelit Taffler argumentojmë se kompania Teteks Yarnë gjatë procesit të falimentimit nëpërmjet një plani të mirëfilltë të riorganizimit menaxhon me sukses problemet e jolikuiditetit duke shlyer obligimet e skaduara. Treguesit tjerë të performancës së kompanisë si: kapitali punues, testi acid, fleksibiliteti financiar, aktiva totale, të hyrat e përgjithshme, shpenzimet e përgjithshme dhe obligimet reale ishin faktorët kryesorë që ndikuan në mosfalimentimin e kompanisë. Perlllogaritja e bankrotit potencial me modelin Altman, Konan - Holder dhe Taffler të kompanisë Shik Jellak argumentojnë se që nga viti 2005 kanë ekzistuar elemente të falimentimit të kompanisë.

Nga rezultatet e perlllogaritura shihet qartë se bankroti i Shik Jellakit ka qenë i pashmangshëm, mirëpo vlen të theksohet fakti që këtu nuk kemi plan të riorganizimit të ndërmarrjes në fjalë, por nëpërmjet procesit të falimentimit erdhëm deri tek shlyerja totale e detyrimeve të ndërmarrjes, gjë që ishte e pamundur të realizohet kur ndërmarrja ishte aktive. Ky proces u përbyll me sukses pasi që kompania kishte asetë të mjaftueshme si kapital punues dhe patundshmeri në pronësi.

Nëpërmjet analizës empirike të procesit të falimentimit që efektuoi me riorganizim dhe ristartim të kompanisë „Teteks Jarni“, dhe nëpërmjet procesit të suksesshëm të falimentimit të kompanisë „Shik Jellak“, argumentuam hipotezën kryesore të këtij punimi. Një plan i mirë i riorganizimit të debitorit të falimentuar ndikon pozitivisht në mënyrë që debitori në proces të falimentimit të mund të vazhdojë së ekzistuarit. Riorganizimi është një mundësi shumë e mirë për kreditorët sepse nëpërmjet saj kreditorët do të arrijnë arkitime maksimale.

Gjetjet e punimit argumentojnë edhe hipotezën ndihmëse të këtij punimi që ka të bëjë me menaxhimin e suksesshëm të procesit të falimentimit nga udhëheqësi i falimentuesit nëpërmjet një programi reformues që ben ristrukturimin e borxheve dhe ndryshimin e strukturës pronësore të kompanisë. Ky punim mund të ju shërbejë menaxhereve të bizneseve si një model financiar për vlerësimin e aktiveve të kompanisë, burimet e rrezikut kreditor si dhe ekzistencën e elementeve të falimentimit potencial si dhe mundësitë e tejkalimit të vështirësive të likuiditetit dhe ristrukturimit organizativ dhe funksional që do të efektuonte sukses të kompanisë në treg në perspektivë.

Bibliografia

Burime primare:

- Kostovski,D (2007) Ligji për falimentim – Komente ,
- Kostovski,D dhe Haxhi Vasileva, B (2007), Riorganizimi i SHT në proces të falimentimit,
- Informacione nga Ministria e ekonomisë së R.M (2005-2015),
- Ligji për Falim, Gazeta Zyrtare e R.M бp.55/97
- Ligji për Falim, Gazeta Zyrtare e R.M бp.34/06
- Brajanovski,B., Beliçanec,T. dhe Nikolovski,A.- Komentimi i ligjit për Falimentim
- Rufi Osmani, Analiza financiare - ligjerata të autorizuara,UEJL,2015,
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.52/91
- Dika, M-Procesi i falimentimit te kompanive ne Kroaci , (1998), Zagreb
- Magda Bjaxhiq, Jelisaveta Vasiliq, Ljubinka Kovačević, Komentimi i ligjit për falimentim, institucioni ekonomik dhe financiar, Beograd 2004.
- Balcaen, S. Ooghe,H.(2006), 35 years of studies on business failure:An overview of the classic,
- statistical methodologies and their related problems, The British Accounting Review
- Beaver, W., (1966), Financial Ratios as Predictors of Failure, Empirical Research in ccounting:
- Selected Studies 1966, Journal of Accounting Research 4
- Spathis, C.,T. (2002) Detecting false financial statements using published data: Some evidence from Greece, Managerial Auditing Journal 17/4
- <http://homes.chass.utoronto.ca/~szhou/print/ForecastingBankruptcyHazardModel.pdf>
- <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download;jsessionid=7938C2582C9DE1654CE9345E85C6657B?doi=10.1.1.653.9254&rep=rep1&type=pdf>
- http://www.bus.tu.ac.th/departement/thai/download/news/957/Altman_1968.pdf
- <http://www.teteksyarngroup.mk/en/index.php>